



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



01

REPUB. E KOSOVËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA  
052-2571/18  
09.09.2018  
Klina

## R A P O R T

I PUNËS SE EKZEKUTIVIT PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2017

KLINË, MARS 2018.

## PËRMBLEDHJE

Viti 2017 karakterizohet për ekzekutivin komunal si vit i realizimit të synimeve dhe objektivave të parapara sipas Ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të Administratës Komunale, më qellim që të arrihen kushte sa më të mira për qytetaret e kësaj Komune.

Administrata komunale gjatë periudhës 2017 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilsore dhe profesionale të qytetarve, në rioorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente më media, OJQ shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim dhe qasje transparente më qytetaret.

## DREJTORIA PËR FINANCA EKONOMI DHE ZHVILLIM

### **Përmbledhje**

Gjatë vitit 2017 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin mbi Financat Lokale, udhëzimeve administrative nga Qeveria Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që dalin nga to dhe bazuar në Planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2017, siç vijon:

Janë përgatitur dhe lëshuar 970 aktvendime të ngarkesave me taksës për licenca të subjekteve afariste që operojnë në komunën e Klinës në vitin 2017, të cilat aktvendime ju kanë dorëzuar të gjithë obliguesve të taksave në afatin e paraparë ligjor.

Janë lëshuar 107 aktvendime të ankesave sipas procedurave të parapara ligjore,

Janë pranuar dhe janë shqyrtuar në terren 2 ankesa të arritura të tatimit në pronë sipas afatit ligjor të paraparë nga MF, për të cilat të gjithë ushtruesve të ankesave ju është lëshuar aktvendim lidhur me epilogun e ankesës, të cilat aktvendime janë dorëzuar në sektorin e caktimit të tatimit në pronë për ekzekutime pas plotfuqishmërisë së tyre.

Janë lëshuar 22 Aktvendime të lokaleve komunale që shfrytëzojnë hapësirën publike sipas urdhrimit të eprorit kompetent, dhe pëlqimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike,

Janë lëshuar 27 vendime të përgjithshme administrativo-juridike të Drejtorisë.

Janë lëshuar më se 205 vërejtje me shkrim për obliguesit e taksave që nuk i kanë kryer obligimet e taksave në këtë periudhë.

Janë lëshuar më se 61 akte administrativo-juridike, që ndërlidhen me Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Është bërë çregjistrimi-shlyerja i 93 obliguesve të taksave komunale të regjistruara dhe që nuk kanë zhvilluar aktivitet biznesi e që kanë mbetur borxhe të bartura nga vitet e mëparshme sipas provave të ATK-es

Në këtë sektor problem kyç është mosregjistrimi i disa subjekteve afariste që operojnë në komunën tonë ilegalisht dhe ato që i kanë mbyllur subjektet afariste, por nuk ju kanë nënshtruar procedurave ligjore të çregjistrimit, që paraqesin problem serioz gjatë ngarkesave vjetore të atyre subjekteve që nuk kanë sjell prova të dëshmuara për ndërprerje të veprimtarisë, respektivisht të mosaktivitetit afarist të tyre, por në koordinim me organet tjera relevante kompetente, si Inspektoratin Komunal etj. Në të ardhmen këtë problem kemi filluar ta evitojmë, por ende ka punë.

## Raport financiar për buxhetin , të hyrat dhe shpenzimet për periudhen janar – dhjetor 2017


Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhen janar – dhjetor 2017 do të japim një pasqyrë të buxhetit , të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore , do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhen e njejt të vitit paraprak .

### Buxheti i aprovuar dhe sipas SIMFK i vitit 2017 sipas burimit

Burimi	Buxheti sipas SIMFK 2017	% në total	Buxheti sipas SIMFK 2016	Ndryshimi nga 2016 në %
Granti qeveritar	7,814,737.74	84.29 %	7,515,661.16	3.98 %
Të hyrat vetanake 2017	1,030,520.58	11.12 %	1,028,000.00	0.25 %
Të hyrat e bartura	328,662.55	3.55 %	206,498.01	59.16 %
Participimi i qytetarve	17,022.31	0.18 %	36,484.31	- 53.34 %
Save the Children	11,597.03	0.13 %	63,488.21	- 81.73 %
Qeveria Japoneze	68,229.00	0.74 %		
USAID			44,795.70	
IOM			6,000.00	
<b>Gjithsej :</b>	<b>9,270,769.21</b>	<b>100</b>	<b>8,900,927.39</b>	<b>4.16 %</b>

Tabela 1. Buxheti në SIMFK për janar-dhjetor 2017 sipas burimit

Siq shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2017 është më i lartë për rreth 4.16 % se buxheti për periudhën e njejtë të vitit 2016 .



Grafiku 1. Buxheti në SIMFK për janar- dhjetor sipas burimit



**Buxheti i realizuar në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar në periudhen janar – dhjetor 2016**

Burimi	Buxheti sipas SIMFK 2017	% në total	Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2017	Progresi ndaj buxhetit	% në total	Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2016	Krahasim i 2017 me 2016 në %
Granti qeveritar	7,814,737.74	84.29 %	7,726,650.41	98.87 %	88.38 %	7,511,739.25	2.86 %
Të hyrat vetanake 2017	809,364.92	11.12 %	614,981.50	75.98 %	7.03 %	522,829.15	17.63 %
Të hyrat e bartura nga	328,662.55	3.55 %	305,514.61	92.96 %	3.49 %	196,118.63	55.78 %
Participimi i qytetarve	17,022.31	0.18 %	16,000.00	93.99 %	0.18 %	31,362.00	-48.98 %
Save the Children	11,597.03	0.13 %	11,596.63	100 %	0.13 %	63,488.21	-81.73 %
Qeveria Japoneze	68,229.00	0.74 %	68,229.00	100 %	0.78 %	-	-
USAID						44,795.70	-
IOM						6,000.00	-
<b>Gjithsej :</b>	<b>9,049,613.55</b>	<b>100</b>	<b>8,742,972.15</b>	<b>96.61 %</b>	<b>100 %</b>	<b>8,376,332.94</b>	<b>4.38 %</b>

**Tabela 2. Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar në periudhen janar – dhjetor 2017**

Buxheti i shpenzuar në periudhen janar – dhjetor 2017 në vlerë 8,742,972.15 € është 96.61 % e buxhetit të realizuar për vitin 2017.

Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 7,726,650.41 € (98.87 % në raport me buxhetin nga Granti ), nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 614,981.50 € ( 75.98 % në raport me buxhetin nga të hyrat e realizuara për 2017 ) , nga të hyrat e bartura janë shpenzuar 305,514.61 € (92.96% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura ),nga participimet e qytetarve janë shpenzuar 16,000.00 € (93.99% në raport me mjetet nga participimet e qytetarve), nga donacioni i Save dhe Children janë shpenzuar 11,596.63 € (100% në raport me buxhetin nga ky donacion ) , nga donacioni i Qeverisë Japoneze janë shpenzuar 68,229.00 € (100% në raport me buxhetin nga ky donacion) . Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 8,742,972.15 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 88.38 % , nga të hyrat e vitit 2017 janë shpenzuar 7.03% , nga të hyrat e bartura 3.49 % , nga participimet e qytetarve 0.18% , nga donacioni i Save dhe Children 0.13 % , dhe nga donacioni i Qeverisë Japoneze 0.78% . Krahasuar me vitin paraprak , në vitin 2017 shpenzimet në total në vlerë 8,742,972.15 € janë më të larta për rreth 4.38% se shpenzimet e vitit 2016 që ishin 8,376,332.94 € .

## Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2017 sipas kategorive ekonomike


Përshkrimi	Buxheti në SIMFK 2017	Shpenz. janar-dhjetor 2017	% në total	Shpenz. janar-dhjetor 2016	Krahasoni 2016 me 2015 në %
Paga dhe mëditje	5,670,150.47	5,669,196.97	64.84 %	5,674,867.65	-0.10
Mallra dhe shërbime	669,906.14	618,253.87	7.07 %	606,417.19	1.95
Shërbime komunale	221,405.17	200,330.35	2.29 %	161,095.48	24.36 %
Subvencione dhe transf.	78,235.18	76,899.13	0.88 %	61,655.63	24.72 %
Kapitale	2,409,916.59	2,178,291.83	24.91 %	1,872,296.99	16.34 %
<b>Gjithsej :</b>	<b>9,049,613.55</b>	<b>8,742,972.15</b>	<b>100 %</b>	<b>8,376,332.94</b>	<b>4.38</b>

Tabela 3. Shpenzimet e buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2017 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2017 në vlerë 8,742,972.15 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 5,669,196.97 € ( 64.84 % e shpenzimeve ), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 618,253.87 € ( 7.07% e shpenzimeve ), për shërbime komunale 200,330.35 € ( 2.29 % e shpenzimeve ), për subvencione 76,899.13, € ( 0.88 % e shpenzimeve ) dhe për kapitale 2,178,291.83 € ( 24.91 % e shpenzimeve ).

Shpenzimet në periudhën janar- dhjetor 2017 në vlerë 8,742,972.15 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2016 në vlerë 8,376,332.94 € janë rritë rreth 4.38% . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogluar 0.10 1.87% , shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur për 1.95 % , shpenzimet për shërbime komunale janë rritur për 24.36 % , shpenzimet për subvencione janë rritur për 24.72 % dhe shpenzimet për kapitale janë rritur për rreth 16.34 % .

## Shpenzimet për janar-dhjetor 2017 sipas kategorive



Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në periudhen janar – dhjetor 2017 sipas kategorive



Të hyrat e realizuara në periudhen janar-dhjetor 2017 dhe krahasimi me periudhen e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	KODI EKONOMI K	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Janar-dhjetorr 2016	% në total	Janar-dhjetor 2017	% në total	Krahasimi 2016/2017	Ndryshimi në €
1	40110	TATIMI NE PRONE	297,767.80	34.15	269,569.76	29.92	-9.47	-28,198.04
2	50001	TAKSAT PER RRUGE	62,770.00	7.2	66,030.00	7.33	5.19	3,260.00
3	50009	URBANIZEM	57,066.53	6.54	44,078.41	4.89	-22.76	-12,988.12
4	50011	TRANSAKCIONI						
5	50013	ÇERTIFIKATAT E LINDJES	23,106.50	2.65	21,505.00	2.39	-6.93	-1,601.50
6	50014	ÇERTIFIKATAT E KUROREZIMIT	8,088.00	0.93	7,314.00	0.81	-9.57	-774.00
7	50015	ÇERTIFIKATAT E VDEKJES	922	0.11	947.50	0.11	2.77	25.50
8	50016	ÇERTIFIKATAT TJERA	21,544.00	2.47	19,406.00	2.15	-9.92	-2,138.00
9	50017	TE HYRAT TJERA	6,281.00	0.72	6,923.89	0.77	10.24	642.89
10	50019	TAKSAT ADMINISTRATIVE	6,728.95	0.77	8,934.50	0.99	32.78	2,205.55
11	50103	LARGIMI DHE DEPONIM I AUTOMJETE.	922.5	0.11			-100.00	-922.50
12	50104	INSPEK.-DEN. MANDATORE	1,470.00	0.17	530.00	0.06	-63.95	-940.00
13	50205	KOMISIONI INSPEKTUES	4,979.00	0.57	2,834.50	0.31	-43.07	-2,144.50
14	50217	LICENCIMI	65,416.00	7.5	67,033.50	7.44	2.47	1,617.50
15	50403	SHITJA E PASURIS	9,701.01	1.11	6,865.00	0.76	-29.23	-2,836.01
16	50405	SHFRY.I PRONES PUBLIKE	4,579.00	0.53	2,252.00	0.25	-50.82	-2,327.00
17	50406	QER.PER TREG TE HAPUR	1,010.00	0.12	5,765.00	0.64	470.79	4,755.00
18	50407	QER.E LOKALEVE(OBJ.AFAR)	6,187.00	0.71	1,938.00	0.22	-68.68	-4,249.00
19	50408	QER.E BANESAVE (OBJ.SOCI.)	4,782.93	0.55	2,842.96	0.32	-40.56	-1,939.97
20	50409	PARTICIPIM-KULTURA-ARSIMI	12,167.00	1.4	19,779.00	2.20	62.56	7,612.00
21	50409	PARTICIPIM-QERDHJA	13,649.00	1.57	18,627.00	2.07	36.47	4,978.00
22	56000	DONACION -arsimi	9,819.77	1.13	79,826.03	8.86	712.91	70,006.26
23	50409	PARTICIPIM-SHENDETESIA	24,843.60	2.85	24,841.10	2.76	-0.01	-2.50
24	50413	PARTICIPIMET-QYTETARET	21,100.00	2.42	11,900.00	1.32	-43.60	-9,200.00
25	50504	GJEODEZI&KADASTER	64,954.00	7.45	65,238.80	7.24	0.44	284.80
26		GJOBAT NGA TRAFIKU	34,206.50	3.92	75,784.00	8.41	121.55	41,577.50
27		GJOBAT NGA GJYKATAT	107,970.00	12.38	70,325.00	7.80	-34.87	-37,645.00
		<b>GJITHESEJT:</b>	<b>872,032.09</b>	<b>100</b>	<b>901,090.95</b>	<b>100.00</b>	<b>3.33</b>	<b>29,058.86</b>

**SHPENZIMET BUXHETORE PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2017 DHE NDRYSHIMI ME VITIN 2016**

Nr.rend.	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet 2017	Shpenzimet 2016	Ndryshimi
1	11110	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	4,830,728.95	4,835,303.03	-4,574.08
2	11115	PAGESA PER SINDIKAT	25,031.67	25,030.76	0.91
3	11125	ANTARSI –ODA E INFERMIERVE TË KOSOVES	503.50		503.50
4	11400	PUNT. ME KONTRATË	9,969.24	8,578.41	1,390.83
5	11500	TATIMI NE TARDHURA PERSONALE	264,327.15	266,068.97	-1,741.82
6	11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORI	269,318.23	269,970.69	-652.46
7	11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI	269,318.23	269,915.79	-597.56
<b>TOTALI: 11</b>		<b>RROGAT DHE PAGAT</b>	<b>5,669,196.97</b>	<b>5,674,867.65</b>	<b>-5,670.68</b>
8	13130	SHPEN.UDHTIMIT BRENDA	12,955.40	11,884.42	1,070.98
9	13131	MED.UDHT.ZYRT.BRENDA VENDI	759.74		759.74
10	13133	SHPENZ. TJERA TE UDHT.ZYRT.BRENDA VENDIT	5,951.16	11.80	5,939.36
11	13140	SHPEN.UDHTIMIT JASHT VENDIT	710.60	125.4	585.20
12	13141	SHPEN.UDHTIMIT JASHT VENDIT	3,271.40	3,969.80	-698.40
13	13310	SHPENZ. PËR INTERNET	1,973.05	2,658.44	-685.39
14	13320	SHPENZ.E TELEFONIT- MOBIL	18,774.25	21,813.01	-3,038.76
15	13330	SHPENZIMET POSTARE	120.10	207.70	-87.60
16	13410	SHERBIMET E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT		193.60	-193.60
17	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	126,066.77	101,429.84	24,636.93
18	13470	SHERBIME TEKNIKE		241.00	-241.00
19	13501	MOBILJE ME PAK SE 1000 EURO		8,701.70	-8,701.70
20	13480	Shpenzime për antarsim	8000.00		8,000.00
21	13490	Sherbimet e varrimit	1000.00		1,000.00
	13501	Mobilje më pak se 1000 €	1,690.00		1,690.00



22					
23	13503	KOMPJUTER MË PAK SE 1000.00 E		16,841.64	-16,841.64
24	13505	MAKINA FOTOKOPJUESE	2,242.00	2,242.00	0.00
25	13506	PAISJE SPECIFIKE MJEKSORE	2,940.00	2,077.00	863.00
26	13509	PAISJE TJERA<1000 EURO	8,896.41	33,948.42	-25,052.01
27	13610	FURNIZIME PERZYRE	57,142.27	53,339.69	3,802.58
28	13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)	11,858.32	15,655.49	-3,797.17
29	13630	FURNIZIME MJEKSORE	13,958.70	17,247.63	-3,288.93
30	13640	FURNIZIM PASTRIMI	15,526.58	7,347.78	8,178.80
31	13650	FURNIZIM ME VESHMBATHJE	10,494.00	4,260.40	6,233.60
32	13710	VAJ	1,000.00		1,000.00
33	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE	34,540.03	24,394.18	10,145.85
34	13730	VAJ PËR NGROHJE QENDRORE	300.00		300.00
35	13750	QYMYR	13,500.00	7,106.52	6,393.48
36	13760	DRU	95,362.97	97,105.11	-1,742.14
37	13770	DERIVATE PER GJENERATOR	2,535.03	472.30	2,062.73
38	13780	KARBURANTE PER VETURA	64,438.54	48,276.80	16,161.74
39	13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	4,225.14	3,015.00	1,210.14
40	13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	9,709.18	6,015.28	3,693.90
41	14010	MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE	21,055.07	37,739.36	-16,684.29
42	14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE	7,764.30	4,837.74	2,926.56
43	14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE	32,188.47	39,211.44	-7,022.97
44	14040	MIRMB.TEKNO.INFORMATIVE	4,195.19	1,017.53	3,177.66
	14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE	7,088.61		2,246.03

45				4,842.58	
46	14110	QIRAJA PER NDERTESA		5,000.00	-5,000.00
47	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET	899.99	7,490.00	-6,590.01
48	14230	SHPENZ.PER INFORMIM PUBLIK	496.00	2,605.00	-2,109.00
49	14310	DREKAT ZYRTARE	11,144.60	9,539.59	1,605.01
50	14410	SHPENZIMET- VENDIMET E GJYKATAVE	3,480.00	3,552.00	-72.00
<b>TOTALI: 13</b>		<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	<b>618,253.87</b>	<b>606,417.19</b>	<b>11,836.68</b>
51	13210	RRYMA	91,391.00	94,864.76	-3,473.76
52	13220	UJI	48,078.09	26,723.69	21,354.40
53	13230	MBETURINAT	55,834.66	33,849.02	21,985.64
54	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	5,026.60	5,658.01	-631.41
<b>TOTALI: 14</b>		<b>SHPENZIMET KOMUNALE</b>	<b>200,330.35</b>	<b>161,095.48</b>	<b>39,234.87</b>
55	21110	SUB.PER ENTITETET PUBLIKE	44,592.40	27,000.00	17,592.40
56	21120	SUB.PER ENT. PUBLIKE KULT.(TEA.BIB.)	19,956.73	34,655.63	-14,698.90
57	21200	SUB.PER ENTITETET JOPUBLIKE	12,350.00		12,350.00
<b>TOTALI: 20</b>		<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	<b>76,899.13</b>	<b>61,655.63</b>	<b>15,243.50</b>
58	31110	NDERTESAT E BANIMIT		215,119.70	-215,119.70
59	31121	OBJKTET ARSIMORE	67,546.60	197,279.49	-129,732.89
60	31124	OBJKTET SPORTIVE		8,604.62	-8,604.62
61	31126	RRETHOJA	28,134.99		28,134.99
62	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	377,200.78	863,877.77	-486,676.99
63	31240	TROTUARET	684,471.00		684,471.00
64	31250	KANALIZIMI	197,900.00	161,791.46	36,108.54
65	31260	UJESJELLES		77,402.14	-77,402.14
	31270	MIREMBAJTJA INVESTIVE	178,776.39		104,060.32



66				74,716.07	
67	31510	FURN. ME RRYMË,GJENERIM E TRANSMIS.		25,870.53	-25,870.53
68	31620	MOBILJE		1,588.00	-1,588.00
69	31640	KOMPJUTER		4,736.52	-4,736.52
70	31650	MAKINA FOTOKOPJUESE		2,478.00	-2,478.00
71	31660	PAISJE SPECIALE MJEKSORE	21,900.00		21,900.00
72	31690	PAJISJE TJERA	80,000.00	1,214.30	78,785.70
73	31700	VETURA ZYRTARE	19,449.00		19,449.00
74	31701	KAMION		1,580.00	-1,580.00
75	31703	VET. E NDIHMES SE SHPEJT	26,230.00		26,230.00
76	31910	AVANS PER INVESTIME	496,033.07		496,033.07
77	32000	INVESTIMET NE VIJIM		130,439.69	-130,439.69
78	33200	TRANS.KAP.-ENTITETET JO PUBLIKE	650.00	5,099.94	-4,449.94
79	34000	PAGESA - VENDIME GJYQESORE		91,298.76	-91,298.76
80	35010	QENI-ASIS.NE RUAJTJE TE SIG.		9,200.00	-9,200.00
<b>TOTALI: 30</b>		<b>PASURIT JO FINANCIARE</b>	<b>2,178,291.83</b>	<b>1,872,296.99</b>	<b>305,994.84</b>
<b>TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30</b>			<b>8,742,972.15</b>	<b>8,376,332.94</b>	<b>366,639.21</b>

## DREJTORIA E ADMINISTRATËS

### ***RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT për 2017***

Kuvendi i Komunës së Klinës, ka mbajtur 9 seanca të rregullta deri me zgjedhjet lokale të tetorit 2017.

Kuvendi ka mbajtur në muajin Dhjetor dy seanca: 1 Inauguruese dhe 1 të Jashtëzakonshme në legjislaturën e VI – lokale po në këtë vit dhe 1 në fillim të vitit 2017, gjithëset 2 të Jashzakonshme

Ka mbajtur 2 seanca Solemne “17 Shkurtin” Shënimi i Ditës së Pavarësisë dhe “18 Qershori” Dita e Çlirimit të Komunës së Klinës.

Kuvendi gjithësejt për vitin 2017 ka mbajtur 14 Seanca.

Ka miratua 31 vendime ( ka miratuar në afat ligjor Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018-2020 dhe Buxhetin për Komunën e Klinës 2018)

Ka miratua 5 rregullore Komunale  
Ka miratua 6 Plane komunale ( 3 ne konsultim me publikun dhe tri vetëm ne KPF dhe KK).  
Ka miratuar një Strategji-Për Zhvillimin ekonomik 2017-2021

Të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë në afat në MAPL, përveç dy vendimeve që janë kthyer për rishqyrtim dhe të cilat me afat ligjor janë rishqyrtuar.

Shërbimi i Kuvendit ka dërguar për publikim në ueb faqën e komunës që të gjitha. Me vendime dhe rregullore janë njoftuar: Kryetari i Komunës, Arkivi i Komunës dhe gjithë subjektet implementues të tyre.

Kuvendi çdo herë iu ka përmbytur dispozitave ligjore në fuqi: LVL, Statutit të Komunës si dhe Rregulloreve komunale.

Janë miratuar vendime ma me rendësi për komunën:

Vendim- për miratim të planit komunal të integritetit 2017-2019

Vendim- për Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturisë 2017-2021 Rishq.

Vendim-për Hartim të Hartave Zonale të Komunës së Klinës

Vendim-.për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake prej 2015 dhe 2016 në 2017

Vendim- Ndarja e lokacionit për ndërtim të Qendrës Rinore në Klinës nr.587-2 ZK Klinë

Vendim-për miratim të punës së Ekzekutivit 2016

Vendim-.Rishikimi i Buxhetit 2017

Vendim-.miratim të Raportit Financiar .Janar-Mars 2017

Vendimi- për miratim të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës 2018-2020

Vendimi- për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Klinës për periudhën 2017-2021

Vendimi - për miratim të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021

Vendimi- për miratimin e Raportit financiar të komunës për periudhën Janar-Qershor 2017

Vendimi- për miratimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2018.

Kuvendi ka miratuar 5 Rregullore:

Rregullorja për menaxhimin e mbeturisë në komunën e Klinës

Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të rregullores për ndarje të bursave për studentet e Komunës së Klinës.

Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjopa komunale/ mars 2017

Rregullorja për tatimin në pronën e palujtëshme

Rregullorja për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre

Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin Komunal në detaje, janë të ruajtura në Shërbimin profesional për punë të Kuvendit.

Vërejtjet: nga Këshilltarët janë që ekzekutivi të jetë ma efikas në sjelljen e materialit për KK dhe KPF të sjellën me kohë materialët që materiali të mos shkoj gjatë seancës.



Komitetet obligative:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa
2. Komiteti për Komunitete

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2017:

KPF, ka mbajtur 9 seanca te rregullta  
Ka shqyrtuar 37 kërkesa dhe shumicën i janë dërguar me rekomandim në seancën e Kuvendit Komunal si dhe ka shqyrtuar çdo kërkesë tjetër të ardhur nga Kryetari, Drejtoritë komunale, subjektet juridik dhe fizik.  
Ka shqyrtuar Propozim-vendime, draft-rregullore si dhe draft-Plane komunale para së të shkojnë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.  
Gjatë mbajtjes së seancave dhe shqyrtimit të çështjeve të parashtruara janë mbajtur procesverbalet të cilat ruhen pranë shërbimit profesional për punë të kuvendit.

Komiteti për Komunitete 2017

Ka mbajtur po ashtu 9 seanca të rregullta,  
Ka shqyrtuar kërkesa dhe ka bartur rekomandimet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kuvend.  
Për të gjitha seancat e mbajtura janë mbajtur procesverbalet që ruhen pranë shërbimit profesional për punë të kuvendit.

Komitetet Tjera:

Komiteti për Shërbime Publike,  
Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban, Kadastër dhe MM dhe  
Komiteti për shërbime publike kanë mbajtur mbledhje gjatë vitit 2017 ndërsa  
Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe  
Komiteti për Pronë, nuk kanë mbajtur asnjë takim për mos kompensim të mëditjeve.

Komitetet Konsultative :

Komiteti për Çështje Emergjente dhe  
Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Këto komitete nuk janë mbajtur asnjë , për mos kompensim të mëditjeve.

Sa i përket punës së Komitetit për komunitete dhe komiteteve tjera si dhe komiteteve Konsultative, raportin e bene Zyrtari administrativ për punë të Kuvendit –B.G.

#### *SEKTORI I GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIMIT*

Nga sektori i gjendjes civile dhe regjistrimit, në periudhën raportuese janë bere 1186 regjistrime te ndryshme lindjes,martese,dhe vdekjes janë lëshuar gjithsejtë 53.261, lloje te certifikatave dhe akte tjera. Lendet e ardhura nga Gjykatat, 120( shkurorëzimi i martesave, dëshmi vdekje,pranim i atësisë, vërtetim për regjistrim në LAL dhe ndërrim – korrigjim nga librat amëz). Lëndët e punuara nga Shefi i gjendjes civile – 252 (regjistrim i mëvonshëm në LAL, korrigjim - ndërrim i emrit dhe mbiemrit, aktvendim për anulimin e regjistrimeve dhe procesverbale për dëgjimin e dëshmitarëve ).  
Për vitin 2017.  
Janë inkasuar taksë administrative prej 53,097, €.

## **RAPORT I PUNES SE ZYRES SE PROKURIMIT PER VITIN 2017**

Zyra e prokurimit ne baze te LPP dhe Organogramit te Komunes , punen e vete e kryen bazuar ne LPP 04/L-042 I ndryshuar dhe amandamentuar me ligjet 04/L-237 ate nr.05/L-68 dhe 05/L-092 si Udhezuesit dhe rregullores per Prokurim Publik , Ligjin mbi menagjimin e Financave publike dhe Ligjeve qe kane te bejne me qeshtje administrative .

**Zyreja ne afatin ligjor ka bere planifikimin e PP i cili eshte miratuar ne Kuvendin komunal, dhe eshte dorzuar ne APP .**

**Ne kete vite kemi inicuar 100 procedura te prokurimit, nga te cilat jane perfunduar 98 procedura ne teresi dhe jane lidhur 101 kontrata dhe 5 Aneks Kontrata.**

**Vlera e kontratave te Lidhura eshte 3.943.445.00 €.**

**Dy procedura jane nderprer pa u perfunduar me kerkese te Njesive kerkuese te cilet kane hjekur dore nga nevojat per ato procedura ( Arsyeja qe pas ankesava te perseritura ne OSHP , kane kaluar afatet e deshirueshme dhe per Nevoja per ato kontratave jane konsideruar te panevojeshme).**

**Qe jane:**

- 1. Pergaditja e projekteve zbatuese per rruge , trotuareve dhe urave , E cila e filluar ne muajin shkurt deri ne shator nuk mundi te finalizohet andaj pas kesaj kohe Njesia kerkuese nuk pati me nevoje per kete project meq periudha zbatuese vetem kishte perfunduar ,**
- 2. Furnizim me GPS –Edhe per kete nevoje Njesia kerkuese ka hjekur dore nga Arsyeja qe ne nderkohe u pa nevoja per dy Aparate te tilla dhe filloj aktivitetin kur siguroj Mjete buxhetore per furnizim me dy aparate .**

**Vlene te ceket se Zyra e prokurimit ishte shume transparente dhe te gjitha procedurat I ka bere publike ne eebfaqe te Krpp dhe komune.**

**Nga 01.01.2017 ka filluar prokurimi elektronik dhe te gjitha procedurat me vlere te mesme dhe te madhe jane udhequr me e- prokurim**

**Gjate kesaj periudhe eshte bere Auditim i Pasqyrave Financiare per vitin 2016 pjesa permbyllese dhe Pjesa hyrese per vitin 2017 nga Auditori gjeneral,**

**Gjate vitit 2016 kemi pasur 7 ankesa ne OSHP kater nga keto jane per dy procedura .te cilat per arsyeira te njohura jane kethyer ne Ri- Vleresim.**

**Pas Ri vleresimit jane perfunduar procedurat konform Vendimeve te OSHP dhe ne harmoni me LPP .**

**Zyra e Prokurimit bazuar ne Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe pergjegjesive obligohet te nxjerr Urdherblerjet per cdon Obligim pagese andaj ne vitin 2017 jane nxejrrre 2710 urdherblerje ne vlere totale**



prej 2.685.573,51 euro.

## **KERKESE IMEDIATE PER MENAXHMENTIN PER FUNKSIONIM NORMAL TE ZYRES SE PROKURIMIT NE PERIUDHEN VIJUESE.**

### **KERKSESA:**

1. Kompletim i stafit , meq Zyra funksionon me vetem dy punetor :  
Menaxherin dhe zyrtaren administrative
2. Krijim te kushteve per pune –hapsire te duhur , meqe ka ne dispozicion vetem nje zyre me 20 m2 qe vetem tani nuk ka vend per vendosje te dokumenteve qe jane tejet voluminoze dhe te renesise se veqant.

Sqarim : Ku ky institucion ( Zyra e Prokurimit ) i nivelit te komunave te njejta qe nuk ka me pqak se 5 zyrtare ne Zyre te Prokurimit dhe ate Jurist , Inxhiner . Ne institucionin tone qe menaxheri i prokurimit qe nuk eshte i stimualuar me graden –koficientin e pages nen 10 derisa Menaxheri i Klimes eshte i stimuluar me 7.5 ( Per kete ka pasur vrejte nga Auditori i pergjitheshem dhe ne atev kohe eshte marr nje vendim per korrjgim te ketij problemi qe ende nuk eshte jetesuar edhe pse vendimi eshte ende VALID.

### **PROBLEMET E FUNKSINIMIT :**

Edhe metej zyra e prokurimit ballafaqohet me te njejtat probleme Sikurse Viteve te mapareshme .

Keto jane :

1. Inicimi i procedurave pa gene te planifikuara
2. Pa Raport Arsyeshmerie nga Njesia implementuese e kontrates per vonesa ne afatin e kryerjes se puneve ato edhe me tej po perseriten.
3. Pune shtese apo te pa planifikuara , qe jane pasoj e mos pergaditjes siq duhet e Projektit apo paramasave .

Kerkoj nga ZKA qe te ndikoj ne te gjitha hallkat qe keto gjera te mos perseriten dhe te respektohet nga te gjitha te implikuarit ne procesin e prokurimit respektim i LP 04/L-042te Ndryshuar dhe amandamentuar me Ligjin nr. 04/L-237 ate 05/L-086 dhe 05/l-92

qe kerhoet :

- 1.Kerkesat vetem per ate se cfare eshte planifikuar,me prijashtime per projekte qe jane nga Donator te mundeshem ,
- 2.Te mos Fillohet procedure e prokurimit pa gene e planifikuar ( vetem ndonje emergjencave ekstreme ) pa siguaruar mjetet buxhetore

dhe pa siguaruar projektet zbatuese dhe pershkrim detal i specifikumeve teknike

3. Te kete shtytje ne komisionet qe mos te hezitojne per kryerje te detyrave – apo te stimulohen me ndonje pagese simbolike qe te mund te kem anetar qe do te jene ne komisionet e vlersimit apo hapjes.
4. Te respektohet ne perpikmeri neni 81 te LPP 04/L-042 –Menagjimi i kontrateve Menaxheri i projekteve –apo menaxheri i realizimit te kontrates te raportoje me situatat per realizim te kontrates – pengesat apo voneseat , meq me LPP 04/L-042 parashihet edhe Menaxhimi i kontrates qe eshte Obligative per zyre te prokurimit, e ne kete rast ne mungese te stafit , kjo do te i delegohet njesise kerkuese –perkatesisht Drejtorise qe do ta implementoj projektin .

Nga Viti 2017 ka hyre ne fuqi LPP 05/L-068 i ndryshuar dhe amandamentuar me Ligjin 05/L-092 ku ka ndryshime dhe perpjekjet duhet te jene qe procesi i prokurimit konform ketij ligji .  
Aplikimi i E- prokurimi.

Nisur nga kjo Kerkon edhe staf shtese qe patjeter duhet plotesuar stafi i tanishem sepaku edhe me dy-tre punetor.

Raportit i bashkangjesim edhe :

1. Raporti i detajuar i Kontrave te Neneshkruara publike
2. Raportin e Projeteve kapitale te realizuara dhe ne realizim te filluara ne vitin 2017
3. Raport te detajuar i Obligimeve per vitet ne vijim 2018
4. Tabela e kontrave korniz ( te afateshme ) per mallra dhe sherbime

Abaz Foniqi , Udheheqes i Zyres se Prokurimit

## **Raporti i punës se Shërbimit për punë të Kuvendit-2017**

**-Ky shërbim gjatë vitit kalendarik 2017** ka përgatitur punën për mbajtjen e gjithsejtë 14 seancave të kuvendit.

Janë bërë përgatitjet për 9 seanca të Rregullta të Kuvendit, duke bërë koordinimin për hartimin e pikave të rendit të ditës, përgatitjes së materialeve në bashkëpunim me drejtoritë komunale dhe zyrën ligjore, sigurimin e lekturimit dhe përkthimeve të nevojshme të materialit edhe pse shumë kanë mbetur pa u përkthye në pamundësi të përkthyesit për ti përfundua.

-Është bërë hartimi i Propozim – vendimeve, të cilat kanë ardhur nga Zyra e Kryetarit, se bashku me dokumentacion janë bartur për shqyrtim dhe miratim në seancë të Kuvendit por paraprakisht janë shqyrtuar ne Komitetin për Politikë dhe Financa dhe debate me publikun.



Janë bërë përgatitjet po ashtu për Draft-Rregulloret, **për mbajtjen e Debateve me Publikun që janë mbajtur shtatë (7)**, përgatitjen e procesverbaleve dhe bartjen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

-Njoftimet janë bërë për të gjithë anëtarët e Kuvendit, MAPL, Ekzekutivin, OJQ, OSBE, KFORI, Policia e RKS-njësia në Klinë, radio "Alba" dhe pjesëmarrës të tjerë.

- Njoftimi është bërë publik në ueb faqen e komunës, në objektin e komunës, në bashkësitë lokale, dhe në radion lokale.

Gjatë seancës mbahen procesverbalet, të cilën punë e kryen lektori i komunës (pa asnjë kompensim) edhe pse nuk është punë e tij.

**-Gjatë 9 seancave të Kuvendit janë miratuar 31 vendime dhe 5 Rregullore Komunale, Plane dhe Strategji.**

Janë shqyrtuar Raportet tremujore financiare të komunës dhe Raporti vjetor i Punës së Ekzekutivit.

Gjithashtu edhe draft-rregulloret dhe aktet tjera të miratuara janë protokolluar në afatin prej 7 ditësh dhe i janë dërguar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për konfirmim të ligjshmërisë, Arkivit të Komunës dhe Kryetarit.

Pas Konfirmimit të ligjshmërisë i janë dërguar Zyrës për Informim për publikim në Ueb faqen e Komunës ku aktet behën të plotfuqishme 7 ditë pas shpalljes në të dy gjuhët por përveç vendimeve dhe rregulloreve aktet tjera nuk kanë pasur mundësi të përkthehen nga volumi i madhi punëve sipas përkthyesit.

Gjatë vitit 2017 janë kthyer për rishqyrtim 2 vendime të cilat brenda afatit prej 30 ditësh janë rishqyrtuar në Kuvend dhe janë bartur për konfirmim të ligjshmërisë.

-Janë mbajtur kontakte rreth punëve dhe përgjegjësi që i kemi si shërbim me MAPL, Asosacionin e komunave të Kosovës, më Kryetarin e Komunës, me Kryesuesin dhe drejtorin e Administratës.

Janë dhenë raporte për çdo tremujor për MAPL.

Raporti vjetor është bërë për drejtorinë e Administratës.

Është bërë përgatitja edhe në sallë për mbajtjen e seancave me ndihmën e zyrtarëve ndihmës për punë në shërbimin e Kuvendit.

Kuvendi i Komunës ka mbajtur **2 seanca të Jashtëzakonshme** ku po ashtu janë bërë të gjitha përgatitjet si për seanca të rregullta dhe janë miratuar vendimet .

-Janë mbajtur **dy seanca Solemne** ku janë bërë të gjitha përgatitjet me respektim të afatit për publikimin e njoftimeve dhe janë përgatitur ftesat për anëtarë të KK, për shoqata të dala nga lufta, për pjesëmarrës tjerë nga institucionet komunale, KFOR-i, OSEBE-ja, institucionet fetare, radiot lokale, OJQ-et dhe pjesëmarrës tjerë.

-Është mbajtur edhe **seanca Inauguruese** e Kuvendit të Komunës, ku janë konstituuar organet e komunës, për të cilën janë bërë të gjitha përgatitjet teknike dhe profesionale ku është bërë betimi i Kryetarit të Komunës dhe anëtarëve të kuvendit për mandatin 4 vjeçar, me zgjedhjet e Tetorit 2017. Po në këtë seancë është bërë edhe zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit.

### **Komitetet obligative:**

**Ky Shërbim ka përgatitur punën për mbajtjen e dy Komiteteve obligative:**

**-Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe**

**-Komitetin për Komunitete (KpK).**

### **Komiteti për Politikë dhe Financa**

Ky komitet ka mbajtur gjithsejtë 9 (nëntë ) seanca të rregullta.  
Ka shqyrtuar 37 kërkesa, Draft-rregullore, draft-Plane., draft-strategji

Janë bërë të gjitha përgatitjet duke u mbështetur në pikat e rendit të ditës të propozuara nga kryesuesi i kuvendit, kryetari dhe drejtoritë komunale apo kërkesa të ndryshme duke respektuar edhe LVL, Statutin e komunës, UA si dhe Rregulloret komunale dhe Planin e punës së Kuvendit dhe komiteteve.  
Përgatitjet janë bërë me caktimin e rendit të ditës, kompletimin dhe shumëzimin e materialit, sigurimin e lekturimit dhe përkthimit sipas mundësive të përkthyesit.  
Vendosjen e materialeve në sirtar dhe dorëzimin e tyre në zyrën pritëse si dhe shpërndarja për subjektet tjerë që janë çdoherë pjesëmarrës në KPF .  
Janë mbajtur procesverbalet gjatë mbajtjes së mbledhjes dhe të njëjtit janë protokolluar dhe ruhen në këtë shërbim.  
Janë përgatitur rekomandimet lidhur me pikat e rendit të ditës të cilat janë shqyrtuar dhe bartur për Kuvend.

Janë shqyrtuar:

Draft-Rregullore- 5, propozim-vendime-27, draft-plane-2, strategji-1 si dhe kërkesa të ndryshme-35.

### **Komiteti për Komunitete**

Për punën e Komitetit për Komunitete, Këshillin e Sigurisë në Bashkësi, Komitetet Konsultative si dhe 5 komiteteve të tjera raporton zyrtari Beqir Gashi, i cili në muajin gusht 2018 pensionohet.  
Edhe pse i janë kërkuar disa here këto të dhëna si për MAPL po ashtu edhe për drejtorin e administratës, zyrtari nuk jep përgjigjeje.

### **Debatet me Publikun janë mbajtur 7 debate, në të cilat është debatua lidhur me:**

Draft-Rregulloret-5, plane komunale-2 plus Planifikimi buxhetor, Strategji komunale e ZHE- 2017-2021.

- Rregullorja për Menaxhimin e mbeturinave ne Komunën e Klinës,
- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarje te bursave për Student të Komunës së Klinës,
- Rregullorja për ndryshim dhe plotësimin e rregullores për tarifa,ngarkesa dhe gjoba komunale,
- Rregullorja për tatimin ne pronën e paluejtëshme,
- Rregullore komunale për varreza dhe shërbimet e varrimit
- Korniza afatmesme buxhetore 2018-2021
- Buxheti i Komunës 2018
- Plani i Menaxhimit të Mbeturinave 2017-2021
- Plani i integritetit të komunës
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Klinës.



Këtu është edhe një përshkrim i punëve të Shërbimit të Kuvendit thuaja në vija të trasha nga se këtu punohet në shërbim të ekzekutivit por edhe në shërbim të kuvendit si legjislativ. Ky shërbim është një urë lidhëse në mes të këtyre dy organeve të komunës.

Andaj edhe stafi teknik dhe profesional duke përfshi edhe lektorin dhe përkthyesin gjithherë duhet të kenë një bashkëpunim të ndërsjellt në mënyrë që shërbimi të jetë në nivel të punëve që kërkohen. Pengesat teknike në punë janë: mungesa e një aparati fotokopjues dhe skanues që është më se i domosdoshëm për këtë shërbim për të mos dal nëpër drejtori për të shumëzuar dhe skanuar për nevoja të MAPL dhe të Komunës.

Raportin për Komitetet tjera, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Komitetet Konsultative e paraqet zyrtari për komitete të kuvendit.

#### *ZYRA PRITESE-ARHIVA*

Nga kjo Zyre, janë regjistruar dhe proceduar për vendosje në zyrën e Kryetarit dhe nëpër Drejtori, 5245 lëndë.

Jane regjistruar edhe vertetuar, peshkrime dhe dorshkrime gjate kesaj perjudhe edhe 256 kerkesa te palvë. Është pranuar, regjistruar dhe përcjell 239 lëndë nga posta për të gjitha shërbimet.

Janë punuar 2215 lëndë nga kompetenca e zyrës sipas ligjit në fuqi, si dhe 40 shkresa janë regjistruar për përcjellje në teren tek palët dhe zyrtarët.

Taksa e inkasuar është në vlerë prej 8.115.25 €.

#### *ZYRA E INFORMIMIT*

Zyra për Informim në kuadër të Komunës së Klinës ( Drejtorisë së Administratës), i mbulon të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Komunë, duke përfshire ekzekutivin dhe legjislativin. Ueb faqja nuk ka funksionuar gjatë vitit 2017 për shkak të problemeve teknike në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në mungesë të ueb faqes aktivitetet janë pasqyruar në rrjetin social facebook, faqja zyrtare e Komunës së Klinës ku janë prezantuar aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Kryetarit, drejtorive dhe aktivitete të tjera që zhvillohen në kuadër të Komunës së Klinës dhe më gjerë, konkurset, njoftimet dhe gjithçka që ka qënë teknikisht e mundshme të shpërndahet në facebook. Nga muaji shtator 2017 ëeb faqja ka qënë në fazën testuese dhe janë publikuar gjitha materialet e vitit të cilat tashme në këtë vit janë publike dhe në shërbim të publikut.

Njëherë, kjo Zyrë i ka siguruar të gjitha informacionet të shtypit ditor. Ka marrëdhënie të mira me mediat dhe për të gjitha aktivitetet i njofton mediat vendore.

Zyra për Informim që nga dhjetori i vitit 2011 merret me kërkesat e qytetarëve në Qasjen e Dokumenteve Zyrtare dhe bën raport në çdo tre muaj në Qeverinë e Kosovës, si dhe raportin vjetor. Gjatë vitit 2017 ka pasur 105 kërkesa për qasje në dokumente publike, 86 kanë pasur qasje ndërsa 19 janë refuzuar.

Zyra për Informim, ka filluar të bashkëpunojë edhe me gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe i është dhënë përgjegjësia për publikimin e të gjitha rregulloreve komunale të Komunës së Klinës. Zyra

për Informim ka raportuar edhe të niveli qendror dhe OJQ-të për Transparencë, Qasje në Dokumente Publike dhe gjuhësor.

Gjer në muajin korrik, zyra për Informim është udhëhequr nga Samije Gjergji, ndërsa për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, është zëvendësuar nga Agron Gashi.

### *NJESIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT*

Në kuadër të Njesisë janë zhvilluar aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave e njeriut në përgjithësi (të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuar, mundësi të barabarta, të drejtave të komuniteteve etj).  
Janë përcjellë dhe organizuar trajnime për të Drejtat e Njeriut, punëtori si dhe bashkëpunime OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, zyrtaret për

çështje gjinore të komunave tjera si dhe takime të tjera për arritje të Barazisë Gjinore dhe respektim të Drejtave të Njeriut.

Janë plotësuar raporte për Qeverinë e Kosovës, rreth respektimit të drejtave të njeriut në Komunën e Klinës.

Ti koordinojmë dhe ti mbikëqyrim politikat në Komunë në fushën e të drejtave të njeriut, politikat mbi barazinë gjinore, përdorimi i gjuhëve të barabarta, zbatimimi i politikave të personave me aftësi të kufizuara të drejtat e fëmijëve kundër diskriminimit dhe antitrafikim

### *ZYRA KOMUNALE PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)*

Është punuar dhe koordinuar në procesin e implementimit, planit I veprimit për MSA-në për gjashtëmuajorin vitin 2016 ka zhvilluar 29 aktivitete Komunë, duke kryer punët në koordinim të ngushtë me udhëzimet e marra nga pushteti qendror.

Janë organizuar trajnime në bashkëpunim me organizata vendore dhe nderkombëtare, po ashtu edhe ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me MAPL-në, MIE-ne, MPB-në kryesisht në implementimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Në mars 2016 është miratuar nga Qeveria Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA).

MSA vendosë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes. Ajo përmban dhjetë tituj-kapituj kryesorë.

### *ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE*

Gjatë vitit 2016 zyra e teknologjisë informative ka kryer këto shërbime si Vion, Implementimin e aplikacionit të E-qeverisjes në Komunën Klinës.

Gjatë vitit 2016 në administratën komunal zyra e teknologjisë informative

ka intervenuar në 1864 problem me kompjuter që u janë shfaqur përdoruesve të sistemit të komunës së Klinës ndërsa edhe 320 intervenime në pajisje tjera periferike si Printer, Fotokopje, Skaner, etj.



Me ndihmën e zyrës së teknologjisë informative janë gjeneruar vendimet për ngarkesa të bizneseve me taksa komunale nga drejtoria e financave  
Poashtu kjo zyre e ka mbështetur të gjithë stafin e komunës së Klinës po ashtu edhe në disa shkolla fillore dhe QKMF dhe QPS në problemet që u janë shfaqur gjatë përdorimit të pasjeve të teknologjisë informative edhe të gjitha zyrat e gjendjes civile në terren në komunën e Klinës ku në disa raste edhe ka bërë intervenime në distancë

ndërsa në raste tjera intervenimi është bërë edhe lokalisht dhe koordinimin për intervenimet të problemeve me lidhje VPN.

Po ashtu ka mirëmbajtur Serverët, Databazat dhe Rrjetën të cilët mundësojnë shërbimin elektronik në Komunën e Klinës,

Për vitin 2016 janë marrë të gjitha masat e sigurisë të cilat rekomandohen nga Microsofti dhe nga Agjencioni i shoqërisë së informacioneve dhe janë bërë Backup të dhenave për arsye të sigurisë konform udhëzimeve administrative

#### *ZYRA E PRANIMIT TË MALLIT*

Nga ky sektor është kryer puna e pranimit të mallit të hyrat edhe të daljeve të materjaleve shpenzuese dhe kompjuterëve, printerëve, fotokopjeve e materialeve tjetër shpenzuese gjithashtu janë kryer edhe raporte të pagesave në fribalancë ku numri i tyre është 1373

#### *SEKTORI TEKNIK – LOGJISTIKA*

Nga ky sektor është kryer: ruajtja e objektit të komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organe dhe palët dhe punë tjera sipas nevojës.

#### *ZYRA LIGJORE*

Si në periudhat e viteve të mëparshme edhe gjatë vitit 2017 Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit, në bazë të ligjit dhe rregullativës tjetër ligjore ka kryer dhe përmbushur të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që i ka pasur në kompetencën e saj.

Në kuadër të kompetencës së saj zyra ka kryer përfaqësimin e komunës në të gjitha shkallët e gjyqësorit në nivel vendi, duke përfshirë tërë aktivitetin e përgjegjësisë së përfaqësimit gjegjësisht avokaturës shtetërore.

Përveç përgjegjësisë së lartcekur Zyra Ligjore ishte edhe pjesë e të gjitha debateve dhe takimeve tjera me publikun që ishin mbajtur gjatë periudhës raportuese. Zyra po ashtu ishte pjesë e të gjitha seancave të Komiteteve komunale, e posaçërisht të Kuvendit të Komunës.

Më poshtë këtij raporti paraqitet tabelori i lëndëve gjyqësore të aktualizuara gjatë vitit 2017 si dhe më tutje edhe tabelori i seancave të mbajtura gjyqësore gjatë periudhës raportuese.

#### **Tabelori dhe Komparacioni i lëndëve gjyqësore të aktualizuara-paraqitura gjatë vitit 2017, në raport më të njëjtën periudhë të vitit 2016**



I.	II.
Gjithësejt numri i lëndve në tërë vitin 2017 (Janar-dhjetor)	Vrejtje
<b>35</b>	Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e sipër të gjykatat kompetente.

I.	II.
Gjithësejt numri i lëndve në vitin 2016 (Janar-dhjetor)	Vrejtje
<b>18</b>	Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e sipër të gjykatat kompetente.

Siq shifet nga krahasimet e periudhave raportuese, në vitin 2017 ishin aktualizuar gjithsejtë **35 lëndë të reja gjyqësore** përderisa që ai numër i lëndëve në vitin 2016 ishte gjithsejtë **18 lëndë**. Nga kjo pasqyrë shihet se numri i lëndëve në vitin 2017 ishte më i madh për **17 lëndë**. Kjo paraqet një trend të shtuar të gjykatës lidhur me aktualizimin e lëndëve gjyqësore gjatë viti 2017, përderisa siç paraqitet më poshtë, numri i seancave të mbajtura nga gjykata ishte zvogëluar

Krejt ato lëndë kishin pasur kerkesëpadit e natyrave të ndryshme juridike sidomos Kërkesëpadi civile-kontestimore si: Vërtetim pronësie, pastaj nga lëmija e Mardhënjes se punës, e Drejta e shfrytëzimit të tokës komunale-trojet ndërtimore, Borgjet përkatëse financiare të komunës ndaj subjekteve të tjera dhe e kundërta si dhe lëndë të tjera.

Sa i përket shqyrtimeve gjyqësore dhe seancave gjyqësore të mbajtura të gjykatat e vendit gjatë tërë vitit 2017 janë mbajtur gjithsejtë **142 seanca të shqyrtimeve gjyqësore** duke përfshie ato pregaditore dhe ato të rregullta. Në krahasim me vitin paraprak 2016 që ishin mbajtur **179 seanca gjyqësore** del diferenca që në vitin 2017 ishin mbajtur më pakë **37 seanca**.

**Tabelari dhe Komparacioni i seancave gjyqësore të mbajtura gjatë tërë vitit 2017, në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2016**

I.	II.
Gjithësejt numri i seancave në vitin 2017 (Janar-dhjetor)	Vrejtje
<b>142</b>	
Gjithësejt numri i seancave në vitin 2016	Vrejtje

Më pastaj Zyra ligjore dhe Përfaqësimit si në të gjitha vitet e mëparshme ka përfaqësuar komunën edhe në të gjitha nivelet ministrore sa i përket përfaqësimit të lëndve konkrete administrative, ku ka lind nevoja, po edhe të këshillimeve përkatëse për të gjitha çështjet juridike. Në këtë drejtim zyra ka marr pjesë në të gjitha takimet zyrtare që i ka organizuar Asociacioni i Komunave të Kosovës që kanë të bëjnë me zyrat ligjor. Kjo

është më rëndësi të ceket se në ato takime behën përpjekjet e unifikimit të veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi.

Zyra po ashtu Drejtorisë së Financave i ka dërguar Informatën e lëndëve gjyqësore të vitit 2017, duke përfshirë edhe lëndët nga vitet paraprake, mbi të cilën informatë ajo drejtori më pastaj ka përcaktuar lëndët të cilat do të mund të ishin si **detyrime kontingjente** gjatë vitit 2017.

Zyra ligjore dhe e Përfaqësimit ishte përfaqësuese edhe në nivele të tjera të organeve dhe asociacionet tjera të Shtetit të Kosovës si është Agjencioni Kosovar i Privatizimit, pastaj Agjencionit Kosovar të Pronës (ish HABITAT-it), Zyrës Rajonale në Pejë kur është paraqitur nevoja e pranimit të vendimeve grupore të KPA-së se më Zyrën komunale për Mardhënje Pronësore-juridike.

Po ashtu zyra ka pas raporte të ndërsjellta edhe bashkëpunim, si për çdo vit edhe këtë vit me Zyrën e OSBE-së në nivelin komunal dhe Rajonal në Pejë.

Zyra po ashtu si në vitet paraprake ka bashkëpunuar dhe ka ndihmuar edhe Sherbimin për Punë të Kuvendit në pregaditjen e tërë materialeve dhe vendimeve në aspektin e sigurimit të bazës juridike dhe ligjore, po edhe në ndihmën e hartimit të tyre sipas nevoje, duke përfshirë këtu pjesëmarrjen në seanca të Kuvendit të Komunës si dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Komiteteve të obligueshme komunale si trupa ndimëse të Kuvendit të Komunës.

Zyra Ligjore po ashtu në kuadër të kompetencave të veta gjatë tërë viti 2017 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për Zyrën e Kryetarit të Komunës po ashtu edhe për tërë Ekzekutivin komunal, si: vendime, Urdhëresa, Pelqime, Aktvendime, ka hartuar Marrëveshje të ndryshme, Autorizime, Konkluzione e shkresa dhe akte të tjera të cilat radhitën si në vijim:

193 vendime; 9 njoftime; 24 kërkesa; 10 autorizime; 1 Urdhëresa; 8 pëlqime; 2 marrëveshje; 6 përgjigje; 3 kontrata; 4 shkresa përcjellëse; 2 deklarata; 2 padi; 4 ankesa; 8 procesverbale, 2 fjalë përfundimtare si dhe 4 akte tjera përcjellëse.

Pë të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në sherbimin e intranetit të Zyra e Kryetarit si të Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit i është ndërruar statusi i lëndve ashtu sipas vendosjes se tyre nga organet kompetente.

Po ashtu ZL ka raportuar në MAPL në Divizionin e Përformancës lidhur me 15 shërbimet komunale sipas formularve përkatës të MAPL-ës.

Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore zyra po ashtu ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkuara nga strukturat tjera të administratës komunale.

Zyra edhe gjatë vitit raportues ka qenë në rrjedha të përcjelljes së ndryshimeve përkatëse ligjore të të gjitha ligjeve që prekin kompetencat e pushtetit lokal, krejt kjo më qellim edhe të nxerrjes së rregulloreve përkatëse komunale siç ishte Rregullorja për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit dhe mirëmbajtjen e tyre, Plotësim ndryshimi i Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjopa komunale, Rregullorja për Palestrën Sportive si dhe Plani i Transparencës.



Po ashtu zyra si çdo vit ka pasur një bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve ligjore dhe komentimeve të projekt ligjeve përkatëse të cilat i janë derguar Asosacionit të Komunave të Kosovës, përmesë të cilit vlenë të theksohet dhe çmohet organizimi i takimeve të zyrtarve ligjor të komunave të Kosovës ku ka marr pjesë edhe zyra e jonë, duke marr pjesë edhe në trajnimet përkatëse të organizuara nga AKK-ës dhe në përkrahje të OSBE-së.

Një aktivitet koordinimi dhe bashkëpunimi vlenë të ceket edhe më Zyrën Komunale të Personelit, sidomos për çeshtjet ligjore që i referohen këtij resori.

Për përfundim mund të konkludojm se Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit gjatë vitit 2017 ka pasur një aktivitet më të shtuar në përmbushjen e kompetencave ligjore të saja në respektim të ligjit dhe drejtësisë.

## **DREJTORIA E BUJQESISE PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Fillimisht është bërë plani i punës për vitin 2017 në bazë të cilit Drejtoria e Bujqësisë do të kryej të gjitha punët dhe aktivitetet e saj.

Duke pas parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë në fillim të vitit ne si drejtori e kemi përgatit planin e mbjelljeve pranverore të cilin në vazhdim do të paraqesim në formë tabelore:

Sa i përket mbjelljeve pranverore në Komunën e Klinës për vitin 2017 janë planifikuar të mbillen këto kultura:

<b>Nr.</b>	<b>Kultura</b>	<b>Sipërfaqja në ha</b>
1	Misër	2940
2	Tërshërë	380
3	Perime	210
4	Patate	135
5	Bimë foragjere	745
6	Të tjera	55
	<b>Gjithsej</b>	<b>4465</b>

Realizimi i mbjelljeve të planifikuara për vitin 2017

<b>Nr.</b>	<b>Kultura</b>	<b>Sipërfaqja në ha</b>
1	Misër	2935
2	Tërshërë	370
3	Perime	205
4	Patate	125
5	Bimë foragjere	737
	Të tjera	53
	<b>Gjithsejt</b>	<b>4425</b>

Siç shihet nga tabela plani i mbjelljeve është realizuar gati në tërësi me disa ndryshime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve të mbjella.



Dinamika e punëve ishte tejet e ngarkuar fillimisht me fermerët të cilët kanë aplikuar për subvencione të : Grurit, Misrit, Pemëve, Perimeve, Lopëve qumështore, Deleve, Dhive, Dosave, Bletëve, Qumështit si dhe realizimin e projekteve nga Komuna.

Në Drejtorin e Bujqësisë në Klinë deri me tani janë të regjistruar 1576 fermer në regjistrin e fermës e cila është bazë për aplikim me qëllim të përfitimit të subvencioneve dhe grandeve.

Me fillimin e aplikimit të subvencioneve ne si drejtori paraprakisht i kemi njoftuar fermerët për afatin dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe gjatë kësaj periudhe procesi ka shkuar mirë, interesimi i fermerëve ka qenë i madhe dhe çdo vite është në rritje. Kësaj i ka kontribuar edhe subvencionimi nga Ministria e Bujqësisë dhe mbështetja nga Komuna.

Për vitin 2017 kanë aplikuar për të gjitha llojet e subvencione ne MBPZHR 946 fermer (Pemëtari, Perimtari, Drithëra, Blegtori dhe Qumësht).

Ne si drejtori kemi përcjell edhe fushatën e korrje shirjeve gjatë gjithë kohës, gjendjen teknike të autokombajnave dhe njëkohësisht i kemi këshilluar për mos djegien e sipërfaqeve të korrura (hamulloreve) sepse kjo paraqet rrezik për ambientin dhe dëmton strukturën e tokës. Rendimenti i grurit këtë vit ka qenë jo i kënaqshëm ( 3870 kg/ha) duke marrë parasysh kushtet jo të favorshme klimatike.

### *Nga Drejtoria e Bujqësisë këtë vit janë realizuar këto projekte :*

-Ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave bujqësore nga penda e Zllakuqanit (Pataqan) në drejtim të Radullocit në gjatësi 1016 m ne vlerë 27448 €

-Ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave bujqësore ne fshatin Grabanicë në gjatësi 1163 m ne vlerë 29317 € €

-Ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave bujqësore në fshatin Dollovë në gjatësi 1300 m ne vlerë 24379.66 €

Dy projektet e fundit nuk kanë mund të përfundojnë si rezultat i kushteve atmosferike dhe neglizhencës së kompanive punë kryese. Lidhur me këtë disa here kemi kërkuar nga pune kryesit që të shpejtohen punët me rritjen kapaciteteve punuese.

Ndërsa nga MBPZHR këtë vit ka përfunduar ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave bujqësore në gjatësi 4250 metra i fituar nga fermerët me përkrahje të DBPZHR Kline në bashkëfinancim me komunën .

Gjithashtu nga MBPZHR kanë përfituar grande shtatë fermer:

Projektet dhe subvencionet kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin e bujqësisë, rritjen e të ardhurave për ekonomi familjare dhe ne zbutjen e qeshjes sociale.

Përpos punëve ditore më palë ne vazhdimisht kemi vizituar fermerët: Blegtor, Bletar, Pemëtar, Lavërtar të cilët i kemi ndihmuar në dhënie e këshillimeve në këto fusha njëkohësisht edhe janë shpërnda edhe broshura me tema të caktuara ne lëmin e bujqësisë.

Për te qen sa me i suksesshëm dhe për tu kryer ne afat optimal mbjelljet vjeshtore ne vazhdimisht kemi këshilluar fermerët qe te bëjnë përgatitjen me kohë të sipërfaqeve, te përdorin farërat cilësore dhe plehrat minerale.

Po ashtu ne mënyrë tabelore po e paraqesim planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve vjeshtore 2017/2018

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e	Sipërfaqet e
-----	---------	--------------	--------------

		planifikuara/ha	realizuara/ha
1	Grurë	4655	4650
2	Elb	70	65
3	Thekër	185	160
4	Foragjere	330	320
	<b>Gjithsej</b>	<b>5240</b>	<b>5195</b>

Gjatë këtij viti janë mbajtur këshillime bujqësore në lëmi të ndryshme të bujqësisë në të cilat kanë marrë pjesë 220 fermer.

Këto trajnime janë organizuar në bashkëpunim me MBPZHR e që ka pas për qëllim aftësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të fermerëve për lëmit me të cilat merren.

Nga pylltaria në gjykatën për Kundërvajtje janë dërguar 68 fletëparaqitje, kallxime penale 9. Po ashtu gjatë këtij viti janë pastruar 12 ha të pyjeve në fshatrat Gjurgjevik të Madh dhe Volljakë.

### DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE

- Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime publike dhe Emergjente funksionojnë këto sektorë: Sektori i Shërbimeve publike dhe shërbimi i zjarrfikësve. Gjatë periudhës vjetore 2017 në sektorin e shërbimeve publike nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej: **315 kërkesa**, të cilat kanë të bëjnë për ujësjellës, kanalizim, pastrimin e rrugëve nga bora, leje për shfrytëzim të hapësirës publike, pëlqime në lokacion të ndërtimit të objekteve afariste dhe banesore kërkesa për ndriçimin publik si dhe kërkesa për ndihem me artikuj ushqimor dhe materialit ndërtimor për ndërtim apo renovim të shtëpive. Drejtoria e Shërbimeve Publike varësisht nga mundësit buxhetore jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

- Të miratuara      140
- Të refuzuara      10
- Në proces          163
- Të pranuar         2

- **Sektori i shërbimeve publike:** Nga kjo drejtori për vitin 2017 janë kryer shumë punë si: mirëmbajtja e rrugëve dimërore dhe verore, ndriçimi eficient i qytetit me drita të standardit me të lart (LED) dhe mirëmbajtja e tyre. Gjatë kësaj periudhe vjetore janë përgatitur dokumentacione për shpalljen e tenderëve që kanë të bëjnë me këtë drejtori ku janë realizuar me sukses të gjitha projektet e lartcekura. Drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjente me projekte bindëse ka hyr në garë për përfitimin e donacionit nga GIZI për menaxhimin e mbeturinave ku kemi plotësuar të gjitha kriteret e caktuara nga GIZI, dhe pasi i kemi plotësuar të gjitha këto kriteret Komuna e Klinës është përfituese e një grandi të madh mjetesh në vlerë prej **293.000 €**. të cilat mjete do të shfrytëzohen për mirëqenjen e të gjithë qytetarëve të komunës së Klinës. Gjithashtu nga kjo Drejtori është punuar një projekt tjetër bindës për eficientë për shkollën fillore në Jagodë po ashtu është përfituese e mjeteve në vlerë prej **56.500 €** edhe ky projekt i fituar donacion nga **AGJENCIONI I EFIÇENCES SE KOSOVES** Gjatë vitit 2017 kemi bërë rehabilitimin e shtratit të lumit "Drini i Bardh" nga ura e Gaxhis deri te fshatin Zajm me qëllim për të bërë parandalimin e daljes së ujit nga shtrati në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore nga të reshurat e shiut, gjithashtu edhe bërë edhe rehabilitimi i shtratit të Lumit në Ranoc dhe Leskoc. Gjatë këtij viti kemi bërë edhe shtruarjen me xhamor të shume rrugëve lokale në territorin e Komunës së Klinës, nga kjo Drejtori është bërë edhe mirëmbajtja e hapësirave publike në qytetin e Klinës dhe mirëmbajtja e shëtitores përgjatë lumit Klina.



Po ashtu zyrtaret e sektorit për shërbime publike kemi qen te kyçur ne komisione për hapje te tenderëve te ndryshëm dhe po ashtu ne vlerësimin e tenderëve tjerë. Përveç punëve te kryere sipas planit vjetor te punës janar –dhjetor, janë kryer edhe këto punë dhe aktivitete:

- Pastrimi i qytetit ne bashkëpunim me qendrat rinore, fillimi i aksionit për pastrimin e ambientit nga mbeturinat e lehta ne muajin prill.
- Lëshimi i vërtetimeve për rastet e djegies te pronave nga zjarri.
- Lëshim te procesverbaleve policisë për vendshiqim te zjarreve
- Lëshimi i pëlqimeve ne lokacion kundër zjarrit te objekte te larta afaristo banesore
- Plani për menaxhimin e mbeturinave
- Rregullorja për menaxhim te mbeturinave
- Plani i integritetit
- Pëlqime te përkohshme për shfrytëzimin e hapësirave publike për objektet afariste
- Pëlqime te përkohshme për shfrytëzimin e hapësirave publike me reklama

Duke patur parasysh ditët e nxeha të verës të cilat fillojnë nga muaj maj, shtohet edhe rreziku i shpërthimit të zjarreve në fusha, shkurre dhe male e sidomos gjatë korrje-fshirjeve si gruri, elbi, tërshëra etj, qe rrezikohen nga zjarri andaj si drejtori kemi marr disa masa për parandalimin e rrezikut të zjarrit, kështu qe i kemi bërë disa reklama apo postera, dhe i kemi shpërnda në të gjithë tërëtorin e komunës së Klinës, gjithashtu edhe nëpërmes informimit te radio Albës me qellim të vetëdisimit të qytetareve që mos të bëjnë ndezjen e zjarreve të pa nevojshme, dhe rezultati i informimit ka bërë se korrje-fshirjet janë kryer me shumë sukses pa pasur nevojë për ndonjë intervenim, situata gjatë terë vitit 2017 mund te vlerësohet e shumë e mirë. Kemi berë edhe 6 raporte mbi vendshiqime të zjarreve, 4 vendshiqime te zjarreve kanë te bëjnë me djegie te shtëpive te banimit 2 rate ne shtalla te mbushura me ushqim te bagëtive. Lidhur më raportet e vendshiqimeve te zjarreve nga Stacini Policor i Klinës është bërë kërkesë gojore për të marrë raport lidhur më shkaktarin e zjarrit.

Nga zyra e alarmimit është bërë grumbullimi dhe distribuimi i të gjitha të dhënave ne Komunën e Klinë dhe të gjitha këto të dhëna janë raportua edhe ne zyrën regjionale ne Pejë. Edhe gjatë këtij viti i kemi vazhduar frekuencat gjithashtu është ber kontrollimi dhe mirëmbajtja e repetitorit në Tigvesh, është bërë edhe kontrollimi i alarmit te qytetit i cili gjendet i vendosur mbi postë qe të jetë ne gjendje gatishmërie ne rast nevojë

- **Sektori Operativ:** NJPZSH në Klinë gjatë kësaj periudhe kohore aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2017 dhe si zakonisht ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat e parapara me plan. NJPZSH ka vazhduar ta mbaj nivelin e gadishmerisë për reagime në rast nevojë edhe për raste emergjente për periudhen e lartëcekur. Ne jemi angazhuar që sherbimet tona të jenë në nivel të përgjegjesisë dhe detyrës që na obligojn ligjet e zbatueshme të Republikës Kosovës. NJPZSH është pergjigjur rasteve sipas obligimeve në përputhëshmeri me kapacitetet tona ekzistuse, jemi pergjigjur me kohë kërkesave të qytetarve të demtuar per paisjen me vërtetime per zjarret e ndodhura. Nga NJPZSH gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithesejt **297** dalje, **267** raste zjarri 1 shërbim dhe **28** intervenime teknike dhe 1 ushtrim „kerkim shpetim” në qerdhen e fmive të inicuar nga kryqi kuq në komunën tone. Në NJPZSH në Klinë diciplina në punë dhe respektimi i orarit të punës është në nivelin e deshirushem, ndrrimet jan kryer sipas orarit të parapara dhe niveli i gadishmeris si zakonisht ishte në nivel të lartë për t'ju pergjigjur kërkesave-nevojave të qytetarve të komunës son dhe më gjër sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuse. Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH gjatë periudhës janar-qershor janë paraqitur në tabelarin që pason:  
Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve dhe struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera për

**JANAR - DHJETOR 2017.**



Viti: 2017 Komuna: Klinë	REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË DALJEVE DHE INTERVENIMEVE PER MUAJN JANAR –DHJETOR 2017							
	Nr.përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Shërbime	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rrejshme.	Të ndryshme	Të lënduar
	297	267	1	28	0	0	1-Ushtrim Kerkim shpetim	0

Viti - 2017	STRUKTURA E ZJARREVE				
	Objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura	Zjarre në automjete	Elektrikë-pajisje elektrike	Të tjera
	11	232	5	2	17

### **DREJTORIA PËR KULTURË , RINI DHE SPORT**

#### *1) SEKTORI I KULTURËS*

- Regjistrimi i anegjistrimi i anëtarëve të rinj si aktor të teatrit “Osman R.Gashi”
- Shënimi i “Ditës se Pavarësisë” 17 shkurt 2017
- Ekspozite individuale e piktorit Refki Racaj, 14 mars 2017
- Ekspozite nga Muzeu i Kosovës ne Klinë,24 mars 2017
- Shënimi i ditës se te zhdukurve (akademi përkujtimore,dokumentar,foto ekspozitë), 4 prill 2017
- Shoë Audicion-Në kërkim te talentave te rinj (aktrim,recitim etj),22 prill 2017
- Repriza e parë e komedis “Keqkuptimi”, 5 maj 2017
- Repriza e dytë e komedisë “Keqkuptimi”, 8 maj 2017
- Kursi i pikturës me talenta të rinj,12 maj 2017
- Koncert i muzikës korale,kori kamertal Siparantum Choir,22 maj 2017
- Komedia “Keqkuptimi” merrë pjesë ne Festivaline Komediive ne Mitrovicë,23 maj 2017
- Komedia “Keqkuptimi” shpërblehet me Çmimin e Parë,ne Festivalin e Komediive ne Mitrovicë, 26 maj 2017

- Shënimi i ditës së fëmijëve (program artistik me fëmijë), 1 qershor 2017
- Përgatitjet dhe mbajtja e festivalit folklorik "I këndojmë Lirisë", 6,7,8 qershor 2017
- Shënimi i ditës së Çlirimit të Klinës, program kulturo-artistik, 18 qershor 2017
- Shënimi i ditës së Diasporës me moton "Ti je pjesë e atdheut", vizitë Bibliotekës "Kongresi i Manastirit", Arkivit Historik, Lokalitetin Arkeologjik në Dresnik, 2 gusht 2017
- Organizimi dhe mbajtja e Manifestimit tradicional letrarë "Ora e Tahir Deskut", 8 shtator 2017
- Shënim i 28 Nëntorit (Program kulturo-artistik në Qendrën e Kulturës "Jehona e Dukagjinit"), 24 nëntor 2017
- Manifestimi tradicional "Art Klina", 25 nëntor 2017
- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit tradicional për fund vit (U ndan mirënjohje për të gjithë ata që kontribuan gjatë vitit në kulturë dhe teatër).

## 2) ZYRA E SPORTIT

- Faza përgatitore për kampionatin pranveror të Kosovës në futboll (KF "Dukagjini") (M),(F)
- Faza përgatitore për kampionatin pranveror të Kosovës në volejbol
- Aktivitete sportive për nder të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës
- Organizimi i turnirëve për nder të festivalit folklorik "I këndojmë lirisë", (futboll (M),(F), volejbol dhe hendboll)
- Organizimi i turnirëve për ditën e Çlirimit të Klinës, (Futboll, volejbol, hendboll)
- Faza përgatitore për kampionatin vjeshtor të Kosovës të klubeve KF "Dukagjini", KFF "Dukagjini", volejbol KV "Dukagjini" dhe hendboll KH "Dukagjini"
- Fillimi i kampionatit vjeshtor në futboll, volejbol dhe hendboll
- Organizimi i turnirëve në disa disiplina me rastin e festës së 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit
- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit tradicional për përzgjedhjen e sportistit të Vitit

## 3) ZYRA E RINISË

- Në bashkëpunim me kuvendin e të rinjve të Klinës organizuam debatin "Toleranca faktare në Klinë"
- Dita ndërkombëtare e Mbrojtjes së Mjedisit (iniciativa për pastrimin e qytetit) në bashkëpunim me qendrën rinore "Ardhmeria"
- Në bashkëpunim me sektorin e sportit organizuam turnirë për të rinjtë e Klinës me rastin e festave tradicionale gjatë vitit kalendarik 2017 si dhe gjatë javës së rinisë në disa disiplina sportive
- Organizimi "Ditët e rinisë në Klinë", u mbajtën: orë letrare me të rinjë, u shfaq komedia "Ëndrra e një nate vere", futboll, volejbol me të rinjë



-Koloni e vogël me të rinjtë e Klinës

-Aktivitet rinor në bashkëpunim me Qendrën Rinore "Ardhmeria" Haloëeen n'Klinë

-Shënimi i ditës ndërkombëtare kundër HIV-it, bashkë organizim me qendrën rinore.

### *ARKIVI HISTORIK I KLINËS*

Në Arkivin Historik të Klinës është bërë një punë e vazhdueshme dhe sistematike në grumbullimin dhe sistemimin e lëndës arkivore brenda territorit të komunës së Klinës. Arkivi Historik i Klinës posedon 30 fonde, me gjithsej 115 metra gjatësi lëndë arkivore. Në vazhden e punëve për rregullimin e lëndës arkivore është punuar në sistemimin e materialit të disa fondeve. Këtë vit është punuar në rregullimin e lëndës të fondkrijuesit Agjencioni Evropian për Rindërtim të shtëpive të dëmtuara nga lufta, gjithsej 5m lëndë. Prioritet për arkivin si edhe viteve tjera ka qenë puna me palë, pranimi i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre. Gjatë vitit 2017 janë pranuar dhe shqyrtuar 141 kërkesa për dokumentacion të ndryshëm që posedon arkivi, çoftë për çështje hulumtimi dhe pajisje me dokumentacion për qytetarët. Nga ky numër i kërkesave 30 nuk janë realizuar për shkak të mungesës së lëndës në arkiv. Janë lëshuar gjithsej 224 kopje të vërtetuara të lëndës arkivore të formatit A-4 (48 kopje) dhe A-3 (176 kopje), si dhe janë lëshuar 28 dokumente nga institucioni i arkivit, kryesisht: dëshmi, vërtetime dhe njoftime. Nga hulumtuesit janë hulumtuar Fondet: Kultura Materiale e Klinës me Rrethinë; Gjimnazi „Luigj Gurakuqi”; Shkolla Fillore „Motrat Qiriazit” Klinë dhe fondi i Arsimit. Me procesverbal janë marrë në dorëzim vulat e vjetra të QKMF „Nëna Terezë” në Klinë. Në muajin shtator për shkaqe shëndetësore është bërë transferimi i ndihmesarkivistës në Drejtorin e Administratës Komunale, ndërsa në arkiv është sistemuar një punëtor i kulturës, si zyrtar i depos.

Gjithashtu gjatë viti 2017 janë bërë disa vizita pune në Agjencionin Shtetëror të Arkivave të Kosovës në Prishtinë si dhe në Arkivat Nderkomunale në Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjiilan ku me drejtues të këtyre institucioneve është diskutuar për legjislacionin arkivor si dhe aspekte tjera me qëllim përfitimin e përvojave dhe standardeve të reja të punës.

### *BIBLIOTEKA E QYTETIT "KONGRESI I MANASTIRIT"*

Biblioteka "Kongresi i Manastirit" gjatë vitit 2017, nga planifikimi i punës për këtë vit ka realizuar 90% të planifikimit. Ka mbajtur evidencën e lexuesve, ku këtë vit numri i lexuesve ka arritur në 640 lexues, nga këta lexues kanë lexuar gjithsej 3050 libra. Kemi biseduar me bibliotekën rajonale në Pejë për ndihmë nga ana e tyre për regjistrimin e librave dhe sistemimin e tyre sipas KUD-it, por në mungesë stafi nga ana e tyre nuk kemi mundur të fillojmë të bëjmë regjistrimin, po ashtu kemi biseduar edhe për programin

digjitalizimit të cilin program e disponon biblioteka rajonale që të na huazoj, mirëpo programeri kërkoj që të bëhet me pages dhe mbetet që në të ardhmen të shikojmë mundësitë buxhetore. Pasurimi i bibliotekës



me fondin librar është bërë me donacione nga MKRS dhe Koha ditore dhe donator nga vet autorët me gjithsej me 442 ekzemplar, që është me rëndësi që këtë vit kemi edhe libra shkencor Mjeksor me një fond të mjaftueshëm për lexuesit e Klinës, pas pranimit të librave është bërë përpunimi i librit evidentimi, regjistrimi i tyre dhe pastaj vendosja në raft për lexues, po ashtu është biseduar me lexues që të jenë me të kujdesshëm për kthimin e librave, është bërë evidentimi i demtimit dhe moskthimit të librave nga ana e lexuesve në çdo vit dhe rezultojnë që librat e demtuar 292 dhe moskthimi i tyre arrin në një numër të madh, është bërë furnizimi i Bibliotekës me material shpenzues për zyrë. Bashkëpunimi me bibliotekën kombëtare dhe rajonale është i mirë dhe do vazhdojë si i tillë.

## **DREJTORIA E ARSIMIT**

Gjatë vitit kalendarik 2017 Drejtoria e Arsimit ka kryer punë, ka realizuar dhe ka bashkërenduar aktivitete e projekte të ndryshme në përputhje me parimet dhe qëllimet e Ligjit të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, të Ligjit të Punës, pastaj mbështetur në Planin e Punës për 2016, në Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit 2017-2019, në Rregulloren unike komunale për personel dhe nxënës, në strategjitë komunale dhe qeveritare, në dokumentet bazë të Kurrikulës si dhe në përputhje me kërkesat e shkollave dhe të problemeve që kanë kërkuar zgjidhje.

Aktivitetet kryesore të Drejtorisë në këtë vit kanë qenë të koordinuara dhe të orientuara në këto fusha:

1. Ngritja e shkallës së cilësisë në procesin mësimor
2. Zgjerimi i hapësirave shkollore
3. Trajnimi i vazhdueshëm i personelit të shkollave
4. Përgatitjet dhe aktivitetet e DKA-së rreth përfshirjes së të gjitha shkollave në zbatim të Kurrikulës në vitin shkollor 2017/2018
5. Krijimi i kushteve më të mira për punë në nivelin 0 ose në edukimin parashkollor e parafillor
6. Përgatitjet dhe bashkëpunimi me MASHT-in për vlerësimin ndërkombëtar PISA 2018
7. Gjithëpërfshirja në arsim
8. Organizimi i garave, konkurseve dhe olimpiadave të niveleve të ndryshme për nxënës
9. Koordinimi i aktiviteteve me MASHT-in për organizimin dhe administrimin e vlerësimit të jashtëm.

Bashkëpunimi me partnerë kompetentë dhe me palë të ndryshme të interesit në arsim, po ashtu ka ndikuar që të kemi një performancë më të mirë në institucionet arsimore sa i përket vetëdijesimit të nxënësve për natyrën dhe rëndësinë e të drejtave të fëmijëve dhe të njeriut, pastaj për kulturën ekologjike dhe për krijimin e një ambienti krejtësisht pa të gjitha llojet e dhunës në shkollë dhe jashtë saj. Këtu hyjnë edhe aktivitetet që janë ndërmarrë nëpër shkolla për vetëdijesimin e nxënësve për t'i mënjanuar pasojat nga trafiku dhe ligjëratat e ndryshme kundër dukurive të këqija dhe pasojave nga to, siç janë droga, trafikimi me qenie njerëzore etj. Në këtë drejtim na ka ndihmuar Policia e Kosovës, FSK-ja, KFOR-i, OSBE-ja dhe OJQ të ndryshme që trajtojnë praktika të tilla.

DKA-ja, sipas planit të punës, ka bërë monitorimin e shkollave sipas kompetencave ligjore, ka identifikuar nevojat e ndryshme materiale dhe ato në lidhje me procesin mësimor, avancimin e cilësisë në mësimdhënie e nxënie si dhe nevojat për trajnim të vazhdueshëm të personelit mësimor.

Si edhe më parë, edhe gjatë vitit kalendarik 2017 ka ekzistuar bashkëpunim i mirë dhe i nevojshëm, i paraparë edhe me ligjet në fuqi, me MASHT-in dhe departamente të ndryshme të tij, pastaj me Sektorin e Inspektimit të Arsimit (Pejë) në Pejë, me GIZ-in gjerman (partner zhvillimor i MASHT-it), me Institutin Pedagogjik të Kosovës, me Shoqatën Matematike të Kosovës, me redaksinë e revistës "Plus" (Tetovë), me



Fakultetin e Edukimit (për avancimin e pedagogëve) dhe me organizata, partnerë të tjerë zhvillimorë e donatorë për përmirësimin dhe avancimin e gjendjes në fusha të ndryshme të institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Klinës.

Në vitin 2017 janë dhënë 20 bursa për studentë të drejtimeve të ndryshme të universiteteve publike, sipas Rregullores për ndarje të bursave studentëve të komunës së Klinës, miratuar më 2016 nga Asambleja Komunale e Klinës dhe sipas kriterëve të Konkursit publik të publikuar nga DKA-ja. Komisioni për ndarje të bursave është emëruar nga Asambleja Komunale. Bursat janë dhënë për studentë të vitit akademik 2016/2017. Mjetet e ndara financiare për bursa janë dhënë nga kodi i subvencioneve të zyrës së kryetarit të komunës.

DKA-ja, në kuadër të veprimtarive kulturore për nder të Ditës së Mësuesit-7 Marsit, si edhe herëve të tjera, edhe më 2017 u ka dhënë mirënjohje mësuesve të pensionuar, mësuesve të dalluar dhe nxënësve të dalluar në gara e olimpiada të ndryshme. DKA-ja po ashtu, për të nderuar Ditën e Mësuesit, ka botuar revistën pedagogjike e kulturore "Mësonjëtorja" ku ka përfshirë historikun dhe zhvillimet arsimore në komunën e Klinës.

### ***Trajnimet në mbështetje të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies***

Sikur edhe viteve të tjera, edhe gjatë vitit 2017 DKA-ja ka bashkëpunuar dhe ka koordinuar aktivitete me MASHT-in dhe me institucione të akredituara për realizimin e trajnimeve profesionale që kanë pasur në fokus përmirësimin dhe avancimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Nga trajnimet më të rëndësishme që janë mbajtur gjatë vitit 2017 po përmendim:

- Nga MASHT-i: trajnime për zbatimin e Kurrikulës me mësimdhënës të parafillorëve, të klasës 1, 6 dhe 10.
- Nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) dhe DKA-ja: trajnim me pjesëmarrës nga të gjitha shkollat për vlerësimin e brendshëm të shkollës.
- Nga organizata "Save the Children": trajnim i personelit të nivelit 0 për sëmundje dhe dëmtime të ndryshme të fëmijëve, siç janë: sindrom Doën, dëmtimet intelektuale; dëmtimet në të parë e në të dëgjuar; tajnime për metodologji bashkëkohore mësimore dhe përshtatje të Kurrikulës në institucionet parashkollore; prezantime e takime të grupeve rrjetëzuese nga Klina, Mitrovica, Ferizaji dhe Gjilani.
- REC-i; trajnim për pakon e gjelbër me arsimtarë të klasës 1-5, të cilët kanë marrë pastaj pakon e gjelbër për nevoja të shkollave të tyre.
- BIT KOSOVA: e-matura, me mësimdhënës të TIK-ut të shkollave fillore.
- MASHT-i: trajnim për planifikim rreth projekteve të Bankës Botërore me përfaqësues të 10 shkollave konkurruese të projekteve.
- CARITAS KOSOVA: trajnim për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, pjesëmarrës nga arsimtarët e lëndës edukatës qytetare.
- QKMF "Nënë Tereza": ligjërata nëpër shkolla me personel dhe nxënës kundër sëmundjes së etheve hemorragjike.
- KEC-i: trajnim për parandalimin dhe referimin e dhunës me përfaqësues të shkollës "Dëshmorët e Qëndresës"-Gllarevë dhe të shkollës "Ismet Rraci"-Klinë.
- AUK-u dhe GIZ-i: trajnime për udhëheqje arsimore.

Instituti Pedagogjik i Kosovës gjatë vitit 2017 në bashkëpunim me DKA-në ka mbajtur disa takime të frytshme me përfaqësues të aktivave profesionale të shkollave për avancimin e



veprimtarive të tyre në shërbim të rritjes së cilësisë në procesin mësimor dhe të aktiviteteve të tjera që kanë të bëjnë me kompetencat e tyre në fusha të ndryshme të Kurrikulës dhe të formimit të përgjithshëm të nxënësit. Kurse GIZ-i ka mbajtur disa takime me drejtorë dhe përfaqësues të shkollave që janë të përfshira në komunitetet e të mësuarit së bashku. Organizata “Syri i vizionit” ka mbajtur takime me përfaqësues të DKA-së, drejtorë shkollash e mësimdhënës për orientimin e nxënësve në karrierë dhe për ndihmesën ndaj nxënësve minoritarë dhe gjithëpërfshirjes së tyre në edukim.

Organizata “Save the children” ka shpërndarë pako të ndihmës së parë në të gjitha shkollat. Një ekspert gjerman i GIZ-it ka dhënë ndihmë profesionale nëpër shkolla për hartimin e planeve zhvillimore të shkollave si dhe për mësimdhënës të shkencave të natyrës.

CARITASI zviceran gjatë vitit 2017 ka pajisur klasat e parafillorëve me inventar dhe me lodra në Jashanicë të Epërme, Përçevë, Këpuz, “Motrat Qiriazit”, Valljak, Ujmirë, Drenoc, Gllarevë.

Në vitin shkollor 2017/2018 në të gjitha shkollat e komunës së Klinës ka filluar të zbatohet kurrikula e re në paralelet parafillore, në klasën e parë, të gjashtë dhe të dhjetë. Koordinatori komunal i cilësisë dhe koordinatorët e shkollave së bashku me drejtorë shkollash dhe përfaqësues të tjerë kompetentë kanë koordinuar aktivitete në shërbim të zbatimit cilësor të Kurrikulës. Koordinatorët e cilësisë nëpër shkolla sipas UA 24/2016 mbajnë orë më pak, për shkak të punës shtesë rreth kurrikulës dhe kjo zbritje e fondit të orëve, duke i zëvendësuar ato me punën shtesë, kushtëzohet nga numri i nxënësve në shkollë dhe në përputhje me UA 24/2016 të MASHT-it.

Në vitin shkollor 2017/2018, sipas shënimeve zyrtare të programit SMIA, në institucionet publike edukativo-arsimore të komunës së Klinës ndjekin mësimet në të gjitha nivelet 8512 nxënës. Numri i personelit nëpër të gjitha institucionet edukative është 653.

### ***Bashkëpunimi dhe koordinimi***

Drejtoria e Arsimit, si edhe në periudhat e mëhershme të aktiviteteve të saj, edhe në këtë vit ka bashkëpunuar dhe ka koordinuar punë e aktivitete, përpos me struktura të pushtetit lokal dhe qendror, konform detyrave dhe përgjegjësiive ligjore, edhe me partnerë dhe palë të ndryshme të interesit në arsim, me organizata të ndryshme qeveritare e joqeveritare dhe në sajë të një bashkëpunimi të tillë është ngritur shkalla e performancës në shërbimet e Drejtorisë dhe në institucionet edukativo-arsimore. Në këtë drejtim duhen përmendur: Policia e Kosovës, FSK-ja, UNICEF-i, KFOR-i, USAID-i, GIZ-i, OSBE-ja, BIT Koosva, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Save the children, Caritasi zviceran, ECMI-ja, Shoqata Matematike e Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit me MASHT-in dhe me mekanizma ndërkombëtarë të BE-së gjatë vitit 2016 janë mbajtur disa aktivitete të rëndësishme arsimore, ku vlenë të përmenden disa konferenca, si: konferenca për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, organizuar nga MASHT-i dhe IPK-ja; konferenca për vlerësimin e nxënësve sipas Kurrikulës së re, organizuar nga MASHT-i dhe Projekti i binjakëzimit, ku kanë marrë pjesë zyrtarë të DKA-së, mësimdhënës dhe drejtorë shkollash.

Sa i përket zgjerimit të hapësirave shkollore, në vitin 2017 kanë vazhduar procesin mësimor në objekte të reja shkollore shkolla e Jashanicës, e Këpuzit dhe e Përçevës, objektet e reja të cilave janë realizuar me investime të Komunës në vlerën prej 626, 774 € dhe me ndihmën e shumës prej 200.000 € nga Qeveria e Kosovës, sipas kërkesës së DKA-së dhe memorandumit të nënshkruar nga Kryetari i Komunës



dhe Ministri i Arsimit. Gjatë vitit 2017 ka filluar ndërtimi i objektit të ri shkollor i shkollës “Ismet Rraci” të Klinës me investime nga Qeveria në vlerë prej 1.086, 709,45 € për periudhën tri vjeçare.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar edhe këto projekte kapitale:

- Renovimi i jashtëm dhe i brendshëm i objektit shkollor të gjimnazit me investim të Komunës me shumën prej 67546.6 €;
- Ndërtimi i rrethojës në shkollën e Gjurgjevikut të Madh me investim të Komunës me shumën prej 10451.16 €;
- Ndërtimi i rrethojës në shkollën e Drenocit me investim të komunës me shumën prej 17683.83 €.

Niveli i kalueshmërisë në fund të vitit shkollor 2016/2017 ishte:

- Niveli 1: 97.43%; niveli 2: 95.25 %; niveli 3: 66.55 %. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kjo kalueshmëri ishte: niveli 1: 96.99 %; niveli 2: 92.99 %; niveli 3: 95.14 %.

### ***Organizimi i konkurseve, garave dhe olimpiadave të niveleve të ndryshme***

Sikur edhe viteve të tjera, edhe më 2017 DKA-ja vetë ose në koordinim me partnerë të tjerë ka organizuar konkurse, gara dhe olimpiada të ndryshme. Janë mbajtur garat tradicionale konkursi “Gjuhëtari i ri” dhe Olimpiada Matematike e Kosovës, pastaj olimpiada gjithëkombëtare e matematikës, organizuar nga redaksia e revistës “Plus” nga Tetova. Më 2017 janë mbajtur po ashtu garat në nivel vendi në lëndën e anglishtes dhe të kimisë, organizuar nga kolegji “Mehmet Akif”.

Nxënës të gjimnazit “Luigj Gurakuqi” kanë marrë pjesë me aktivitete të ndryshme kulturore e gjuhësore në javën e frankofonisë në Prishtinë, organizuar nga ambasada franceze dhe Shoqata e Profesorëve të Frëngjishtes e Kosovës. Dy nxënës të dalluar nga gjimnazi kanë marrë pjesë në kampin javor kulturor dhe sportiv që është mbajtur në Rugovë (Kuqishtë) me qëllim të rekreacionit dhe të zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në gjuhën frënge.

Drejtoria Komunale e Arsimit, sikur edhe deri më tash, edhe gjatë vitit 2017 ka menaxhuar dhe koordinuar veprimet me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, me organet kompetente të nivelit lokal e qendror si dhe me të gjithë partnerët e interesit, në mënyrë që të rriten treguesit e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit, ashtu si kërkohet nga dispozitat ligjore, nga dokumentet strategjike të Komunës dhe të MASHT-it si dhe nga të gjitha dokumentet dhe aktet e tjera zyrtare të Kurrikulës së re të Republikës së Kosovës.

Rezultatet e testit të arritshmërisë të klasës 9, mbajtur më 26 maj 2017						
Nr.	Institucioni/	Vendi	Ko di	Nr.nx. Qe hyne ne test	Poenat	Arritshmëria
1	SHFMU "Ismet Rraci"	Klinë	1	147	9537	64.87
2	SHFMU "Emin Duraku"	Sferrkë	2	48	1979	41.22
3	SHFMU "Motrat Qirazi"	Klinë	3	98	5684	58
4	SHFMU "Ali Krasniqi"	Ujëmirë	4	31	2067	66.67
5	SHFMU "Azem Bejta"	Grabanic	5	37	2036	55
6	SHFMU "D. e Qëndresës"	Gllarevë	6	68	3834	56.38
7	SHFMU "Tre Dëshmorët"	Jashanic	7	58	3313	57.12
8	SHFMU "Atë Shtjefën Gjeqovi"	Zllakuqan	8	44	3178	72.22
9	SHFMU "Avni Zhabota"	Shtupel	9	29	1049	36.17
10	SHFMU "Esad Mekuli"	Cerovikë	10	26	948	36.46
11	SHFMU "Zgjimi"	Gremnik	11	36	1823	50.63
12	SHFMU "Isa Boletini"	Drenoc	12	40	2131	53.27
13	SHFMU "Nëna Terezë"	Budisalc	13	13	600	46.15
14	SHFMU "Ymer Berisha"	Siqevë	14	8	427	53.37
15	SHFMU "Atë Gjergj Fishta"	Jagodë	15	8	437	54.62
16	SHFMU "Deshmoret"	Volljak	16	54	2655	49.16
17	SHFMU "Dëshmorët e Kombit"	Çabiq	17	17	885	52.05
<b>TOTALI</b>				<b>762</b>	<b>42583</b>	<b>55.88</b>

Rezultatet e provimit të maturës-gjinnazi "Luigj Gurakuqi"-afati i qershorit 2017

Shkencat shoqërore			Shkencat natyrore			Gj.i përgjithshëm			Shënime të përmblidhura		
U testuan	Kaluan		U testuan	Kaluan		U testuan	Kaluan		Nxënës që hynë në provim	Kaluan	% e kalueshmërisë së përgjithshme
116	109	93.96 %	93	90	96.77 %	6	4	66.66 %	215	203	94.41 %

Rezultatet e provimit të maturës ne Shkollen e mesme profesionale " Fehmi Agani " Kline afati i qershorit 2017

Profesional 2		Shënime të përmblidhura



Profesional 1			Profesional 3								
U testuan	Kaluan		U testuan	Kaluan		U testuan	Kaluan		Nxënës që hynë në provim	Kaluan	% e kalueshmërisë së përgjithshme
54	35	64.81 %	123	65	52.84 %	15	10	6.66 %	192	110	57.29 %

Shënim: Kalueshmëria në nivel komunal është 76.90

### **DREJTORIA PËR URBANIZEM DHE MBROJTJE TE MJEDISIT**

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës gjithë fushë veprimtarin e vet e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejt e Vendimeve të Asamblesë Komunale

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit vepron:

Shërbimi i ndërtimit dhe Banimit

Zyra për Mjedis  
Planifikimi Urban  
Zyra për Projekte

**Ne kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:**

- Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit
- Legalizimi
- Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit –Planifikim
- Paisja me leje mjedisore komunale.
- Hartim të gjitha paramasave, parallogarite, raporteve dhe projekt propozimeve për donator.
- Mbikëqyrja e ecurisë së punimeve, në pranimit teknike për të gjitha projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie, në inspektime në teren sipas kërkesave të palevë.

Gjatë vitit 2017 në këtë Drejtori janë pranuar kërkesa të për leje ndërtimi, kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për leje mjedisore dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.

Nga kjo drejtori janë lëshuar 31-Lejeve ndërtimore , 6 -Leje mjedisore, 31-Kushte të ndërtimit, 5-pëlqime ,13-vërtetime, 2-referenca DUMM gjatë vitit 2017 ka krijuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **44.078,41 €**.

**Projektet:**

Gjatë vitit 2017 janë hartuar dhe përpunuar paramasat me paralogarit, është bërë ndërtimi-realizimi i projekteve infrastrukturore, dhe ndërtime tjera (objekte) në Komunën e Klinës siç vijon:

#### Projektet e realizuara gjatë vitit 2017

1. Asfaltimi i rrugëve në qytet Bajram Rexhepi dhe Zef Gjidoda
2. Asfaltimi i rrugës Grabanicë –lagja Kodra
3. Asfaltimi i rrugës në Deiq segmenti 1 dhe 2
4. Asfaltimi i rrugëve Deiq segmenti 3 dhe
5. Asfaltimi i rrugëve Jashanicë lagja Rukolli, Myrtaj, Gashi
6. Asfaltimi i rrugës Kepur-Qeskovë
7. Asfaltimi i rrugës Kernicë faza
8. Asfaltimi i rrugës Kernicë faza
9. Asfaltimi i rrugës Shtupel –Bakajat
10. Asfaltimi i rrugës Jashanicë-Myrtaj
11. Asfaltimi i rrugës Stupë-Zajm faza e parë
12. Ndërtimi i kanalizimit Gjurgjevik i Vogel
13. Ndërtimi i kanalizimit Siqevë
14. Ndërtimi i kanalizimit Jashanicë lot 1
15. Ndërtimi i kanalizimit Jashanicë lot 2
16. Rregullimi i shtratit të lumit Klina
17. Ndërtimi i murit mbrojtës në Gremnik
19. Ndërtimi i lëshesës në Radulloc

#### Ndërsa në realizim janë këto projekte:

1. Asfaltimi i rrugëve Jashanicë lot 2 lagja Morina dhe Bajraktari
2. Asfaltimi i rrugës Jashanicë loti 3 prej Xhamisë deri të rruga
3. Asfaltimi i rrugës Jashanicë lagja Kameraj dhe Doqet
4. Asfaltimi i rrugës Jashanicë lagja Halitaj dhe Bullak
5. Asfaltimi i rrugës Jashanicë lagja Shpati
6. Asfaltimi i rrugës Stupë-Zajm faza 2
7. Rregullimi në sheshin në Klinë
8. Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë
9. Ndërtimi i kanalizimit Cerovik
10. Hartimi i HZ

Ndërtim: I objekteve

1. Përfundimi ndërtimi të objektit banesor P+6k.
2. Ndërtimit të shkollës "Ismet Raci" në Klinë, -në vazhdim

Gjatë këtij viti janë mbajtur takime të ndryshme me donator të ndryshme si dhe dikasteret e linjës me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfitimit të projekteve të ndryshme,



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje ete mjedisit gjatë vitit 2017 ka berë edhe pune tjera nga lamija e inspektimit , mbikëqyrjet dhe pranimet teknike te projekteve te realizuara ne komunën e Klinës.

## **DREJTORIA PER KADASTER GJEODEZI DHE PRONESI**

**Shërbimi pronëso-ro-juridik,i ka kryer detyrat e punës në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisive që i ka të përcaktuara në Ligjin mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe statututi të Komunës.**

Në korrik {02.7-deri më 20.7}2017 kemi bërë sistemimi dhe kompletimin e lëndëve,duke i regjistruar sipas viteve, me emrat dhe numrin rëndor të lëndëve të më parëshme,të cilat i ka pranuar ky shërbim.

Qëllimi i ynë ka qënë të bëhët e mundur që lëndët e viteve të kaluara të sistemohen,në mënyr që të gjindën sa më shpejtë,në mënyr,që të jemi sa më praktik për palët e interesuara që kanë nevojë.

**1.-Më 21.korrik deri më 01.gusht.2017,është mbajtur Proqesë i kontaktëve këshilluese më pronarët e tokave që duhet të ju merren-shpronësohen për realizimin e projektit për rregullimin e shtratit të lumit „Drini i Bardhë”që i përfshin katër Zona Kadastrale të Komunës së Klinë.**

- 1.**Zona kadastrale** - Klinë,në sipërfaqe prej:1.93,60 ha,
2. II- II - II - Videj,në sipërfaqe prej:0.16,64 ha,
3. II- II - II - Deiq,në sipërfaqe prej:1.58,24 ha dhe
- 4 II- II - II - Dresnik,në sipërfaqe prej:0.95,32 ha,

**Gjithësejt: 4.63,60 ha.**{katër hektar,gjashtëdhjet e tre ari e gjashtëdhjet metra}.

**2..Lëndët e zgjidhura-pa zgjidhura** gjatë periudhës,Korrik-dhjetor 2017 janë këto:

1.Më datën 13.7/17,është **zgjidhur problemi** në fshatin Gremnik,duke e bërë caktimin e pikave nga gjeodeti,Agron Gashi,që kishin të bëjnë me kufirin e pronës Komunale në njërën anë dhe Familjës Kadri Rudi në anë tjetër.

Palët:Halim Rudi dhe

Përsonat zyrtar:

Dastan Rudi

Zenun Zeqa,zyrtar ligjor,Agron Thaqi.gjeodet

18.8/17,sipas detyrës zyrtare ishim në shiqim tëpunimeve në rregullimin e e shtatit të lumit {Drini i Bardhë}.

Më 11gusht/17,isha në Ministri për sqarimin e projektit të lumit,sepse kishte vërejtje nga pronarët e parcelave.

2. **Kërkesa** e Avokatit Xhafer maloku përfaqësues i familjës Krasniqi nga fshati Qabiq e dt,14.01/2015,nr.11.950-166/15,për lirimin e rrugës publike e uzurpuar nga vëllëzërit Gashi është **në procedur.**

3.**Kërkesa** e shërbimit pronëso-ro-juridik e dt.8.9/17 për Gjykatën Themelore në Klinë,që ka të bëjë me vërtetimin e pronarit të origjinës, kontratës së parë mbi shitblerjën e lokalit afaristë në sip.prej:0.38,80 m<sup>2</sup>,pronë e ish BVI-së,është marrë më datën 11.9./17,dhe vërteton se pronari i parë ka qënë ajo dhe se kontata e parë ishte lidhur pikrishtë në mesë të BVI-së dhe blerësit,2.AT.BKS-Travel me seli në Prishtinë,ndersa Elmi Morina nga Drenasi është blerësi i tretë dhe se ka tër dokumentacionin e duhur për ndyshimin e titullarit,andaj edhe kjo lëndë zgjidhët me dt.15.11/17.

**4.Kërkesë-për Sqarim**,Shërbimi pronëso-ro-juridik,për Ministrinë e Drejtësisë,departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar,lidhur me njohjen-mosënjohjen e kontratës për mbajtjen e përjetëshme,e lidhur në Qaqak-të Serbisë,më datën 29.01/2002,**nuk kemi marrur ende përgjigje.**  
**Nuk kemi marr ende konfirmim-përgjigjeje.**

**Më 21.9/17,ish në zgjidhjen e kontestit te ure e trinit-klinë në mesë të Dushve dhe Palushëve,rasti u zgjidh me shënimin e pikave nga gjeodeti Agron Thaqi,ku bëhet ridefinimi i i pikave ekzistuese.Bashkë me ne ishin e policia e Kosovës dhe inspektorët komunal.**

**5.-Paditës AKP-ja,në Pejë,të ilën e përfaqëson,znj/Antigona A.Halilaj që ka të bëjë me pengim posedimi të pasurisë së paluajtshme-3 objekte të ndetrura në ngastrën nr.327/6,pronë shoqore e kuvendit Komunal të Klinës,në sipërfaqe prej:0.52.00 ha,në ZK.Klinavcë-Jashanicë.**

**E paditur-Komuna e Klinës.pasë mbajtës së seancës së parë me datën 25.9/17,kjo çështje ka mbetur të procedohet më tej,sepse ngastra nr.769/3,në sipërfaqe prej:0.84,29 ha, është pronë e ish NPB-së Malishgan,tani menagjohët nga AKP-ja,në të cilën ngastër është e ndertuar shk.Fillore,,Tre Deshmorët” në Jashanicë.**

**Ky kontest është në procesë të zgjidhjes në mesë Komunës dhe AKP-së përmesë rrugës gjyqësore.por me marrveshtje reciproke,do të mahet me 23.03/18.**

**06.10/17,ishim bashkë më gjeldetin Agron Thaqi dhe zgjidhem kontestin për zgjerimin e rrugës në lagjen e Bardheve-në fsh.Grabanicë.**

**13.10/17,sipas detyrës zyrtare ishim në shiqim të mbylljes së rrugës për: Mark,Ded,Tom dhe Vitor Lleshi.U dakorduar që të filloj procedura e daljes së gjeldetit për verifikim të planit se është servitut{rrugë}publike-apo jo .**

**16.10/17,kemi ankesë të nënshkruar nga dhjetra familjar të lagjes të fsh.Jagod të cilën e përfaqëson Ali Nimani.Rasti ka të bëjë më uzurpimin e pronës Shoqërore komunale,të cilën deri në vitin 2012 ia kishte dhënë me qera,kryetarikomunës.Uakorduar që kur të vijë nga Gjermania Ali Nimani të dalim në vendngjarje.**

**6.-Më 27.10/17,ishim me gjeldetin A.Thaq për caktimin pikave në ngastren 327/6,P.SH.e Kuvendit të komunës,sip.prej:0.52,00 ha.ndesa ngastra në ZK.Klinavcë.**

**Ndërsa parcela nr.769/3 në sip.:0.84,29 ha ZK.Jashanicë është në pronësi të Malishganit,aty ndodhët shk.fill.TRE DESHMORËT.**

**Ky rast ka dy mundësi të zgjidhjes;1.Me marrëveshje me AKP-n dhe 2.Me shpallje si zonë e interesit publik.**

**7-Ankesa e Lumnje Kastratit për bartjen e pronësisë-Banesë,të cilën e përfaqëson znj.Mirdona Gashi,Avokate,nr.463-2990/16,**

**E pranuar me datën 20.10/2017,dërgohet përsqarim-vendosje në AKP-në Prishtinë ,më shkresë-përcjellëse AKP-së, nr.360-5406/17,me dt.10.11/2017.**

**8.-Kërkesë, Agjencia Kosovare e Privatizimit-Zyra Regjionale në Pejë,për informatë,nr.2770/17,lidhur më pronën e ish NPB-së Malishganë-Z.K.Binxhë në sipërfaqe prej:74.94,39 ha.**

**Përgjigjeja është dhënë më datën 23.10/17,se nuk ka as një llojë hipoteke apo ndales tjetër për këtë pronë të cilën e konfirmon zt.Noc Thaqi,gjeodet.**

**9.- Komisioni i AKP-së ,në Pejë, më datën 14.9/17 Refuzon Kërkesën e D.Ribaqit,përbarjete të pronësisë së paluajtshme në ngastrën nr.585 ZK,në Klinë.**

**Ky vendim është ndërmarr në bashkëpunim me zyrtarët ligjor të komunës së Klinës dhe atyre të Agjencionit Kadastral-Pejë.**

**10.-Komisioni i AKP-së,në Pejë Refuzon Kërkesën nr.299/17 të Feriz Sylejmaniit, më datë 10.10/2017,që kishte të bëjë më pronën sipas fletës poseduese nr.447,ZKKlinë,parcela nr.585 .**



11.-Vertetohët me dt.16.8./17,Kërkesa e zt.Abedin Lata,përfaqësues i UNMIK-ut, në Pejë,që ka të bëjë me parcelën nr.00587-2,në sipërfaqe prej:4198 m<sup>2</sup>,pronë shoqërore e KK.Klinë,e eksproprijuar m vendim nr.04.465-20-75,të dt.19.02/1975.

12.-Me datën 26.11/2017,kemi përgjigjje në shkresën drejtuar AKK-së,në Ptishtinë,lidhur me rastin e Ankesës së Lumnije Kastrati, ku nga Drejtoria kërkohen të gjitha shkresat lëndore në bazë të të cilave është marrë Aktvendimi për aprovimin e kërkesës,nr.11/4632/2016,tëdatës28.6.2016

Po ashtu nga pala kërkohet vendimi mbi ndarjen e banesave nr.133,të dt.13.11.1988,si dhe të gjitha kopjet e vërtetuara nga organi kompetent.

13.29.11/2017,vendim nr.14-5676/17,të dt,29.12.2017,për ndryshimin e ngastresë nr.787-0 në zk.Klinave,prej0.43,79 ha,e cila ishte eksproprijuar më par nga komuna e klinës me vendim nr.04.465-9/4,të dt.14.7.1980,vendim icili ishte bërë i plotfuqishëm me dt.07.10.1980,si dhe pjesët:ngastrës nr.295 ZK.Dresnik,sip.0.09,25 ha,pjesa e ngastrës nr.296 në sip.prej:0.17,10 ha,si dhe ngastrës nr.297 në sip.prej 0.01,10 ha..

Ndersa pjesët tjera të ngastrave 787/4 dhe 789/3 mbesin të njëjta .

14.-Me datë ,30.11/17,dërgesë-shkresë- për znj.Mirdona Gashi,Avokate,që nga AKK-ja,kërkohët plotësimi i lëndës lidhur me ankesën për banesë,të dt.13.11.2017.

15. -Lënda ,dërgesë e dokumentacionit shtesë, në tri-kopje,departamenti ligjor,zt.Ismet Kryeziu, kërkesa nr.03/2587/17,të dt.22.11.2017.

Çeshtja ka të bëjë me ankesën e znj.Lumnije Kastrati,lidhur më banesë.

05.12/17,kërkesa e Ali Nimanit nga Jagoda nuk realizohet përshkak të kushteve të dimrit.

## **Statistika nga zyrtarja e RDPP**

**Kërkesat për regjistrimi e bartjes se pronës gjithesejtë:724.Nga to 722 te aprovuara dhe 2 në procedur e sipër**

**Kërkesa për regjistrimin e ndertesave apo pjeseve te banesave:15 dhe te gjitha te aprovuara**

**Kërkesa për ndarjen e parcelave :129 dhe të gjitha te aprovuara**

**Kërkesa për bashkim të parcelave: 26 dhe të gjitha të aprovuara**

**Kërkesa për korrigjimin e regjistrimit të pronës :9 dhe te gjitha te aprovuara**

**Kërkesa për regjistrimin e hipotekave : 55 dhe te gjitha te aprovuara**

**Kërkesa për sherbime tjera:46 dhe te gjitha te aprovuara**

**Numri i pergjithshem I kërkesave :1004, nga to te aprovuara 1002 dhe ne procedur e siper 2.**

**Statistika te puneve nga sherbimi për pranimin e paleve dhe dorezimin e kerkesave:**

**Fleta poseduse:2818**

**Kopje plani 968**

**Certifikata per nevoja te ndryshme 69**

**Kerkesat e pranuar per pune per gjeodetet:340,nga to 190 te perfunduara dhe te tjerat ne procedur**

**108 parcelime te perfunduara**

**14 konstatime**

**22 tregim kufiri**

**19 bashkim parcelash**

**4 nderrim culture**

**19rexfordrim te objekteve dhe banesave**

**10 produkte kadastrale**

**240 identifikate te ngastrave ne zyre**

**35 skica te terenit**

**70 regjistrime te ngastrave te reja ne Gjeomedi**

**28permiresime I vektorit te ngastrave kadastrale**

**23 konstatime per shpronetim**

**108 ftesa te perfunduara me ane te gjykates .**

### **DREJTORIA E INSPEKSIONIT**

Me qëllim të sendërtimit të Strategjisë afatgjate në jetësimin e sundimit të Ligjit dhe luftimin e Informalitetit-veprimeve kundërligjorë të subjekteve që i 'u nënshtrohen kontrollit inspektues, Organet e Drejtorisë për Punë Inspektuese në periudhën raportuese kanë ndermarrur një serë aktiviteteve dhe veprimesh koordinuese në bashkëveprim në disa raste edhe me Policinë e Kosovës në: kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, kontrollin e bizneseve, mbikëqyrjes së rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK-së, KEK-ut dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve ,hapësirave publike etj., respektimit të Orarit të punës së bizneseve hotelierë sidomos gjatë punës në orët e vonshme të natës, mbarëvajtjes së tregjeve javore, mbikëqyrjen e transportit publik, mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit, kontrollin e artikujve ushqimor dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësorë dhe afatshmërisë të përdorimit të tyre, kurse ndërldhur me ketë nga ana e Drejtorisë janë nxjerr një numër i konsideruar i akteve-urdhërësive ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Këtu duhet shtuar se organizimi i punëve dhe detyrave të punës nga ana e Eprorit të Organit dhe inspektoreve, pos punëve të ushtruara në orarin e rregullt të punës, është bërë edhe gjatë ditëve të vikendit, festave fetare dhe shtetërore dhe me caktimin e kujdestarive si dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat si dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore është inkasuar shuma prej **9.306.00€**.

Nga personat fizik dhe ata juridik në nivel të Drejtorisë janë proceduar 378 kërkesa të ndryshme nga të cilat janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore 15 janë refuzuar si të pa bazuara , si dhe 2 janë pezulluar (si të pakompletuara) në procedurën administrativë 2 sosh.

Më qëllim të informimit të ndërsjellë në relacionin: Organet e Inspektoratit dhe Drejtoria në raport me Drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë dhe Ministrinë gjegjëse, janë hartuar informata, raporte ,memorandume dhe relacione tjera zyrtare në kërkesë të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.

Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara ,pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit inspektues sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar më numrin e banorëve në komunën tonë.



Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit Organ të Inspektoratit pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

### **Inspektimet nga Lëmia Publike**

Në këtë lëmi në periudhën raportuese janë ushtruar 210 mbikëqyrje inspektuese e që ka rezultuar me 90 procesverbale të përpiluara në vend. Në objektiv të kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin edhe matarimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorët tjerë në aksione të përbashkëta, dalja në vend dhe shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizik dhe juridik të natyrës përkatëse, në stinë e dimrit organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirim të rrugëve nga bora dhe punët tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij.

### **Inspektimet nga Lëmi i Ndërtimit**

Në këtë resor duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit janë ushtruar 41 kontrole duke përfshirë edhe ato monitoruese inspektuese, janë hartuar 38 procesverbale në vend, shënohen 23 shënime zyrtare të natyrës përkatëse gjatë ushtrimit të aktivitetit mbikëqyrës, duke shtuar këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie, gjatë ditëve të vikendit dhe atyre të festave të ndryshme. Poashtu është koordinuar dhe bashkëvepruar me inspektorët tjerë në kuadër të Drejtorisë në punët e përbashkëta sidomos në kontrollin e eksploatimit të zhavorrit, punët e tregjeve javore, transportin e kombinuesve etj. Nga ky organ janë shqiptuar gjoja në vlerë prej **650.00 €**.

### **Inspektimi në Lëmin e Komunikacionit/trafikut/**

Ky organ në vitin raportues ka ushtruar 60 mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtja e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosja në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me këtë janë hartuar 47 procesverbale si dhe janë evidentuar 23 monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve si brenda lokalitetit të Klinës ashtu edhe jashtë saj përkatësisht të qendrave të lokalitetit në territorin e Komunës së Klinës. Po ashtu është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese në aksione të përbashkëta të planifikuara nga Drejtoria, kurse në proces është zhvillimi i punimeve për vendosjen e shenjave vertikale dhe horizontale të trafikut në qytetin e Klinës nga kompania e cila ka fituar tenderin përkatës.

### **Inspektimi nga Lëmi i Bujqësisë dhe Ambientit**

Gjatë periudhës raportuese nga lëmi i Inspektionit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar 280 inspektime në mbikëqyrjen e dispozitave të Ligjit për Tokën Bujqësore dhe në mbrojtjen e eksploatimit të paligjshëm të rërës dhe zhavorrit, për mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave, në kontrollin e kualitetit të miellit që përdorin furrat e bukës, mbikëqyrje ndaj gurthyesve dhe barnatoreve bujqësore dhe fidanëve/të tjera. Nga kjo 2 kërkesa të ushtruara për iniciimin e procedurës kundërvajtje si dhe 10 gjoja të shqiptuara në vlerën prej **1100,00 €**, në bashkëpunim me Drejtorin e Bujqësisë kemi inspektuar 15 raste për Sëmudjen Gungorë.

### **Inspektimi në Lëminë Sanitare – Komisioni Inspektues**

Në zbatim të dispozitave nga lëmi i mbikëqyrjes sanitare dhe të mbrojtjes shëndetësore të popullatës nga sëmundjet infektuese, atij për duhanin si dhe aktet tjera të kësaj lëmie, Komisioni Inspektues sanitar ka ushtruar 90 mbikëqyrje inspektuese dhe ka përpiluar 56 procesverbale mbi konstatimin e gjendjes në vend. Është punuar aktivisht në transmetimin dhe jetësimin e fushatës në aplikimit të dispozitave ligjore të Duhanit si në rrjetin e objekteve hotelierë ashtu edhe në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës. Pjesëmarrja në Komisionin vlerësues të përcaktimit të kushteve minimale teknike, sanitare-higjenike dhe të tjera të lokaleve dhe bizneseve shënohet në 90 raste. Më nismën e këtij organi dhe në bashkëveprim me Inspektorët Sanitarë të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës të Rep. së Kosovës, është kontrolluar aspekti i përgjithshëm, kushtet sanitaro-higjenike të subjekteve të ndryshme afariste, janë marre strishot e të punësuarve dhe nga mjetet e punës.



**P.S. Nga data 21.05.2014**, Inspektori sanitar është pensionuar kurse punët dhe detyrat me autorizim i ka ushtruar Inspektori i Tregut .

### **Inspektimi në Lëmin e Tregut**

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit /pajisja me Certifikata për Regjistrimin e biznesit/ të të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera dhe pajisja me Pëlqime për plotësimin e kriterëve minimale teknike te lokalit për ushtrimin e bizneseve te ndryshme ka qenë objektiv i punës dhe aktiviteti të këtij organi e që ka ushtruar 250 kontrole inspektuese me ç ‘rast ka udhëhequr 164 procesverbale mbi faktimin gjendjes në vend duke proceduar me nxjerrjen e 97 aktvendimeve përmbajtjesorë për eliminimin e të metave të konstatuara duke i vene afatet dhe duke ushtruar kontrollet kthyesë inspektuese për përmbushjen dhe përmbarimin e të njëjtëve, atë për paralajmërim për mbyllje-ndërprerje të aktivitetit biznesore , po ashtu mbi te njëjtën bazë janë ushtruar edhe 31 monitorime.

Shënohen 59 pjesëmarrje në monitorimin dhe mbarëvajtjen e tregjeve javore si dhe 97 raste pjesëmarrjes në Komisionin vlerësueses për kushtet minimale teknike, higjeno-sanitare dhe të tjera të lokalit duke nxjerra kështu 97 aktvendime për dhënien e pëlqimeve gjegjëse ku janë inkasuar në emër të shpenzimeve komisionarë inspektuese për këtë qellim **5200 €** .Në mbikëqyrjen e Rregullores për orarin e Punës së subjekteve afariste shënohen 12 mbikëqyrje dhe atë më shumë gjatë orëve të vona të natës po ashtu në bash veprim me PK .Në koordinim me Zyrën për biznese janë mbarshtruar dhe është punuar në zgjidhjen e kërkesave për lejimin e zgjatjes së orarit të punës së subjekteve afariste nga lëmia e hotelerisë e që është në përputhje me Rregulloren përkatëse Komunale shënohet për 10 raste. Janë shqiptuar 2 gjoba ne vlere prej **425** euro, Në bashkëpunim me Inspektoret tjerë është larguar qarkullimi i mallit dhe produkteve ushqimore me afat te skaduar për përdorim , te prishur – pa deklaracion ku është inkasuar shuma prej **60** euro ne emër te taksës konformë Rregullores për Taksa dhe Ngarkesa , kurse vlere e mallit te asgjësuar është **11.964.08** euro , Janë ushtruar 2 kërkesa për hapjen e si dhe janë hartuar 13 informata, raporte, shënime zyrtare, sqarime dhe interpretimeve procedurave në vijën horizontale dhe vertikale.

**P.S:/Në pasqyrimin e punëve dhe aktivitetëve punuese për periudhën raportuese nuk është përfshirë puna qoftë vetanake qoftë në bashkëveprim me Inspektoret e Tregut në kuadër të MTI-së sipas Planit të Veprimit të Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, kurse sipas një vije të veçante ka qenë obligimi për raportim periodik dhe vjetor/.**

### **Inspektimi nga Lëmi financiar-/regjistrimit/ të bizneseve**

Në këtë lëmi janë ushtruar 210 mbikëqyrje inspektuese kurse lidhur me to janë hartuar 90 procesverbale për konstatimin e gjendjes në ven. Janë shqiptuar 2 Gjoba Mandatorë ne vlere prej **450** euro Poashtu është bashkvepru me inspektorin e Tregut te hyrat nga Komisioni Inspektues për kushtet higjeno-teknike ne shumën prej **2296** euro si dhe te hyrat vetanake **55** euro. Është punuar edhe me Inspektoret tjerë në nivel të Drejtorisë në aksionet e koordinuara të përbashkëta dhe në monitorimin e tregjeve për 61 raste. Është udhëhequr evidenca e lëvizjes së pagesave të ndryshme në emër të taksave, ngarkesave dhe tarifave dhe kontrolli në përlllogaritjen dhe orientimin e drejtë të tyre.

### **PROPOZIMI I MASAVE:**

Duke konkloduar mbi konstatimet e sipërshënuara dhe efektet e arritura nga periudha raportuese, paraqitet domosdoshmëria në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në:

\*Emërimin e Inspektorit Sanitar sipas procedurave të parapara ligjore dhe atë sa më parë që është e mundur;



\*ngritjen përkatësisht stimulimin material të inspektorëve dukë korigjuar koeficientin në përfitimin e të ardhurave personalë dhe kompensimin për punën gjatë ditëve të festave, vikendeve apo jashtë orarit të punës;

Gjetja e një zgjidhje për magazinimin-deponimin e mallit përkohësisht të konfiskuar pasi që hapësirat e tilla mungojnë me sigurinë e standardizuar.

\*inicimin në Zyrën Ligjore të Komunës për nisjen e procedurave përkatëse të ndryshimit dhe plotësimit të Rregulloreve Komunale që kanë të bëjnë me sfera të ndryshe të rregullimit të jetës dhe punës shoqërore me qëllim të nxjerrjes së Ligjeve të reja nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, lypset përshtatje dhe konform me rrethanat aktuale dhe

\*shtimin e numrit të Inspektorëve sipas standardeve ligjore në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve/në Komunë

## **DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2017, ka vazhduar parametrat e planifikuar të punës institucionale, duke arritur të sigurojë grante dhe donacione masive dhe të planifikojë qartë investimet kapitale për vitin 2018 dhe 2019 për sektorin e shëndetësisë. Po ashtu gjatë këtij viti kemi arritur një avancim të strukturës organizative shëndetësore, të paraparë me Statutin e ri të QKMF-së, adut ky, që shënon etapën e kalimit në një dimension të ri veprues dhe menaxhues, që domosdo tejkalon mandatet politike. Në këtë kontekst, megjithëse, ende mbetet punë për t'u bërë, sidomos në zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Komunal 2017-2021 dhe Statutit të ri të QKMF-së "Nënë Tereza", më në fund, është hapur fuqishëm rruga për implementimin dinamik të mjekësisë familjare dhe precizimin strukturor të përgjegjësisë në sektorët dhe nënsektorët e shëndetësisë. Viti kalendarik është përfunduar me një sukses të madh në sigurimin e shumë granteve dhe donacioneve në vlera të mëdha financiare, siç është Granti i Asistencës Bazike për Siguri Humane i Qeverisë Japoneze, dy grante nga Ministria e Shëndetësisë, një grant nga Kompania IPKO dhe shumë të tjerë në vlera financiare më të ulëta, që përshkruhen më poshtë, të cilat kanë rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka realizuar projekte të ndryshme përmes Qendrës për Punë Sociale, duke ofruar shërbimet e nevojshme nga të dyja ekipet: Ekipi i shërbimeve sociale dhe Ekipi i asistencës sociale, të cilat kanë realizuar mbikëqyrjen e proceseve në bashkëpunim të ngushtë me: Policinë e Kosovës, gjykatat, institucionet shkollore dhe organizatat joqeveritare, për të trajtuar raste të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të braktisur, të adaptuar, me çrregullime martesore, si dhe angazhimin për vetëdijësimin ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, për të rritur në gjendje konfliktuoze, fëmijët me sjellje asociale dhe dhunën në familje.

Synimet e realizuara për vitin 2017 në bazë të menaxhimit sistematik, në kontekst të evidentimit dhe zbatimit të punëve sektoriale, vijnë së prezantuar më poshtë me statistika dhe veprimtari të konkretizuar.

### **Grantet dhe donacionet**

Konkretisht, gjatë vitit 2017, për të funksionalizuar sektorët e ndryshëm shëndetësorë, siç janë: Shërbimi i Laboratorit, Shërbimi i Transportit, Shërbimi i Stomatologjisë dhe Shërbimi i Pediatrikë, si asnjëherë më parë që nga viti 1999 (pra 18 vjet pas luftës), në sajë të shtrirjes së bashkëpunimit dhe kordinimit të mirëfilltë kemi siguruar pajisje mjekësore dhe automjete transportuese për pacientë në vlerë prej **132, 621, 00€**. Ato janë si vijojnë:

- a) Më 9.3.2017 ka arritur donacioni i madh financiar në kuadër të Grantit të Asistencës Bazike për Sigurinë Humane të Qeverisë Japoneze, me ç'rast janë siguruar pajisje laboratorike dhe mjete transporti, si më poshtë: Centrifugë mpë 251, Analizer biokimik abx penra 400, Analizer hematologjik abx micros 60, Mixer Roller dhe Mikroskop bb 152 pli, në vlerën prej 21,900,00 €, një automjet transportues për pacientë të tipit Citroen Jumper Autoambulance në vlerë prej



26,230,00 dhe një (1) minibus Citroen Jumper Minivan për nevojat e pacientëve në hemodializë në vlerë prej 19,449,00€. Të gjitha këto pajisje janë të reja dhe të papërdorura, ndërsa vlera totale e grantit arrin 68, 229, 00€. Në bazë të parametrave të definuar të kriterëve për përfitim, sipas procedurave të konkurimit, koha e përgatitjes voluminoze të dokumentacionit ka përfshirë një periudhë testuese dhe verifikuese gjashtëmujore. Drejtori i DSHMS-së është marrë personalisht në mënyrë intensive me përgatitjen e dokumentacionit dhe finesave të tjera në shqip dhe anglisht. Mbledhja dhe përgatitja e dokumentacionit ka qenë sfidë në vete për shkak të kërkesës për saktësi maksimale dhe dëshmi të shkruara për burimet dhe astetet që nga viti 2013-2016, të cilat janë kërkuar me ngulm nga Qeveria japoneze lidhur me përcaktimin e nevojës dhe të dhënave për autombulancat dhe aparaturat laboratorike të QKMF-së. Andaj, ky grant, pas konklutimit të arkivave të donacioneve del të jetë donacioni më i madh që ka hyrë ndonjëherë në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Klinës, i cili do të ketë ndikime pozitive, sepse krijon parametra për shërbime më cilësore shëndetësore. Më këtë rast duhet shprehur falënderim të veçantë për personelin menaxhues dhe jomenaxhues të QKMF-së, i cili ishte në mbështetje të vazhdueshme të këtij granti, në kuadër të kompetencave të tij.

- b) Ardhja e automjeteve të reja ka imponuar edhe ndërtimin e garazhës në vlerë prej 4242€, sepse ka qenë obligim i shkruar edhe në kontratën e grantit japonez.
- c) Një grant tjetër i rëndësishëm, i përfituar nga Ministria e Shëndetësisë për Shërbimin e Transportit të QKMF-së “Nënë Tereza”: Autoambulanca e tipit A në vlerë prej 34,250,00€ ka arritur në muajin nëntor 2017.
- d) Një donacion i çmueshëm ka ardhur edhe nga Kompania e Telekomunikacionit “IPKO” më datën 12 dhjetor 2017 në vlerë prej 10,000,00€, në kuadër të të cilit hyjnë: pajisje bazike mjekësore, inventar dhe rregullimi i hapësirave të Shërbimit të Pediatriisë. Ky doacion vazhdon së zbauari edhe në vitin 2018.
- e) Një grant tjetër është siguruar nga Ministria e Shëndetësisë nga fondi i zbatimit të të drejtave të garantuara të komuniteteve RAE në vlerë prej 10,000,00€, ku hyn: 1 karrige e kompletuar stomatologjike, 1 EKG – 12 kanalëshe dhe 1 destilator.
- f) Gjithashtu pajisje mjekësore: sterilizator për stomatologji dhe 10 palë gërsërë të tipit PEAN dhe një donacion tjetër për QKMF-në - 7 krevatë dhe 7 joga, i ka dhuruar më 31 gusht 2017 Zyra e LMT-së së KFOR-it të Brigadës Shumëkombëshe Perëndim, në vlerë prej 5,900€.

Më këtë rast duhet të ceket se Shërbimi i Transportit, Shërbimi i Labororit dhe Shërbimi i Pediatriisë në QKMF-në “Nënë Tereza” janë kompletuar me automjete dhe pajisje mjekësore të nevojshme, gjë që, nëse i kushtohet kujdes mirëmbajtjes dhe përdorimit të duhur të tyre, mund të vlerësojmë se janë siguruar pajisje dhe mjete transporti për këto shërbime edhe për 15-20 vjetët e ardhshëm.

#### **Planifikimi buxhetor për sektorin e shëndetësisë, sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore 2017-2019**

Këtë vit është bërë edhe planifikimi buxhetor sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore 2017-2019, me ç’rast janë planifikuar mjetet financiare për investime kapitale në sektorin e shëndetësisë në vlerë prej 160,000,00 €, pa përfshirë këtu Projektin e digjitalizimit të QKMF-së, i cili arrin vlerën 37,350,00 €, që në total bëjnë **197,350,00€**. Në këtë kontekst janë përgatitur projektet e detajuara me paramasat dhe parametrat e plotë nga kompania e kontraktuar projektuese “INFRAPLUS” dhe projektet e tjera përkatëse, të punuara nga personeli përkatës i DSHMS-së.



Projektet e planifikuara kalendarike janë si vijojnë:

1. Për vitin 2018 janë të koduara për investim kapital mjetet financiare në vlerë prej 40.000,00€ për renovimin e hapësirave dhe blerjen e pajisjeve mjekësore të Shërbimit të Urgjencës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Nënë Tereza”, me ç’rast ky shërbim i rëndësishëm do të standardizohet plotësisht për t’u ofruar shërbime cilësore qytetarëve të Komunës së Klinës. Projekti i detajuar me paramasat dhe parametrat e plotë është kryer nga kompania e kontraktuar projektuese “INFRAPLUS” dhe gjendet në zyrën përkatëse administrative.
2. Në vijim për vitin 2018 ka mbetur që të gjendet modaliteti i financimit edhe të një projekti tejet të çmuar shëndetësor, siç është ai për digjitalizimin dhe kompjuterizimin e QKMF-së, projekt ky, të cilin e ka hartuar drejtori i DKSHM-së (në konsultë me profesionistët e fushës përkatëse teknologjike), me ç’rast kostoja e projektit arrin në 37,350, 00 €, pa përfshirë këtu koston e punëmarrësit. Detajet e plota të shtrirjes së këtij projekti do t’i gjeni në kopjen e Projektit për digjitalizimin dhe kompjuterizimin në Departamentin e Administratës së QKMF-së “Nënë Tereza”, e cila do t’i dorëzohet edhe pasuesit që do të drejtojë dhe menaxhojë sektorin e shëndetësisë klinase.
3. Për vitin 2019 janë planifikuar mjetet financiare në vlerë prej 120,000,00€ për renovimin, lysterjen, sanimin e ujësjellësve dhe rregullimin e oborreve të QKMF-së, tri QMF-ve dhe 10 AMF-ve të Komunës së Klinës.


### **Zbatimi i Statutit të ri të QKMF-së “Nënë Tereza”**

Pozitivja praktike e këtij viti të menaxhimit të sektorit shëndetësor ka vazhduar me zbatimin e esencave dhe bërthamave të çështjeve që shpiejnë në avancimin e kërkuar në përputhje me orientimet strategjike. Sipas predispozitave të Statutit të ri janë zgjedhur udhëheqja dhe trupat organizative të QKMF-së: Këshilli Drejtues në përbërje: drejtoresha e QKMF-së “Nënë Tereza”, kryesuese, udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare, anëtar, kryeinfermierja e QKMF-së, anëtare, udhëheqësi i Departamentit të Administratës, anëtar dhe Koordinatorja për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, anëtare. Pas konstituimit të Këshillit Drejtues janë zgjedhur trupat si në vijim: Këshilli profesional, Komisioni Disiplinor, Komisioni i Ankesave, Komiteti për Cilësi dhe Siguri të shërbimeve shëndetësore.

Në këtë kontekst, miratimi dhe fillimi i zbatimit të Statutit të ri të QKMF-së “Nënë Tereza” ka hapur definitivisht rrugën për implementimin dinamik të mjekësisë familjare dhe precizimin strukturor të përgjegjësive në sektorët dhe nënsektorët e shëndetësisë në Komunë e Klinës. Para konstituimit të organeve drejtuese, në zbatim të Statutit të ri të QKMF-së dhe nenit 17, pika 2 të Ligjit të Punës nr. 03\L-212, nenit 18, pikën 3 të Ligjit për shëndetësi nr.04\L-125, nenit 23 të Rregullores nr.2\2015, me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore dhe në përputhje me parimet e konceptit të Mjekësisë Familjare dhe për shkak të nevojave dhe kërkesave të popullatës për përmirësimin e këtyre shërbimeve, drejtori i DKSHM-së ka marrë Vendimin me nr.298, për ristrukturimin dhe riorganizimin e ri të punës në QKMF, QMF dhe AMF.

#### **Mbyllja e Maternitetit– faktorët**

Në këtë rrjedhë planifikimesh institucionale kemi pasur riorganizime, dhe pse jo edhe reformë të tipit organizativ. Materniteti me strukturimin e ri është shndërruar në Shërbim Gjinekologjik. Kjo ka ndodhur pas analizës së detajuar ligjore, profesionale, buxhetore dhe menaxhuese për shërbimet e ofruara në Maternitetin e QKMF “Nënë Tereza”, në të cilin kanë punuar 3 gjinekologë dhe 8 motra medicinale. Faktorët që kanë shtyrë, pa dëshirën tonë, mbylljen e maternitetit janë:





- Rreziqet në lindje, ngaqë QKMF-ja, si ofruese e kujdesit parësor shëndetësor, nuk ka kushtet elementare, si përshembull - dhënien e një doze të gjakut në rast të komplikimeve gjatë lindjes dhe ofrimin e shërbimeve të tjera, që bart ky process i ndërlikuar;
- Mungesa e licencës për zhvillimin e veprimtarisë së Maternitetit për shkak të mosplotësimit të kritereve;
- Shpenzimi enorm i buxhetit, me ç'rast sektori i shëndetësisë është liruar për afro 18,000,00 €, të cilat janë orientuar për nevoja të tjera strategjike shëndetësore.

### **Transparenca e shpenzimeve**

Në zbatim të ligjeve për financat dhe ligjeve të tjera bazike për qeverisjen lokale që performojnë transparencën e përgjithshme dhe llogaridhënien e nevojshme, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka ndërmarrë aktivitete të shtuara gjatë vitit 2017 për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore. Në këtë kontekst kemi arritur të menaxhojmë shpenzimet si është më së miri në Shërbimin e Transportit të QKMF-së, me ç'rast nga 40,000,00€ të planifikuar për derivate kemi realizuar vetëm 27, 876, 00€ për vitin 2017. Kjo tregon efikasitetin e madh, sepse janë kursyer 12,126,00€ nga mjetet që kemi pasur në dispozicion. Dhe mund ta japim vetëm një shembull argumentues: Nëse në tremujorin e fundtë vitit 2013 kemi pasur një shpenzim mujor për derivate në vlerë prej afro 3,500-4,000€ për muaj, në të njëjtën periudhë kohore të vitit 2017 kemi shpenzim minimal nga 1,280-1,600€. Kjo ulje është arritur në sajë të ardhjes së tri autoambulancave të reja dhe mbikëqyrjes strikte të kartelave shpenzuese të automjeteve nga ana e dy punonjësve të dalluar të Departamentit të Administratës: Xhemajl Raci dhe Pashk Demiri. Kështu ka vazhduar edhe në muajt paraprak të këtij viti. Mesatarja mujore e shpenzimit të derivateve del më pak se 2,000€ në muaj. Gjithashtu shpenzime më të vogla janë krijuar edhe në pagesat e energjisë elektrike për QKMF, QMF, AMF dhe Qendrën Sociale, sepse moti i mirë gjatë stinës së dimrit dhe niveli i tarifave kanë mundësuar që të kemi shumë më pak shpenzime. Nga 28,000,00€ të planifikuara për pagesat e shpenzimit të rrymës janë realizuar vetëm 15,171,00 €, gjë që i bie janë kursyer 12,829,00€. Në këtë rast, bashkëpunimi ynë ndërsektorial i institucioneve komunale ka mundësuar që të lidhim marrëveshje të shkruara me Drejtorinë e Arsimit dhe drejtoritë e tjera për të bërë pagesa derivatesh dhe pagesa të shpenzimit të energjisë elektrike dhe të tjera në vlerë prej 24,955,00€.

### **Shërbimet dhe vizitat**

Edhe këtë vit niveli i dhënies dhe marrjes së shërbimeve dhe vizitave shëndetësore për qytetarët e Komunës së Klinës ka qenë i lartë, duke u bazuar në numrin e popullsisë dhe parametrat e tjerë. Ato vijnë si më poshtë:

- Janar, shkurt, mars: 27,093 shërbime dhe 28,784 vizita;
- Prill, maj, qershor: 25,084 shërbime dhe 25,738 vizita;
- Korrik, gusht, shtator: 25,454 shërbime dhe 27,133 vizita;
- Tetor, nëntor, dhjetor: 29, 424 shërbime dhe 26,898 vizita.

Totali i shërbimeve: 107,055 dhe, totali i vizitave: 108,533.

### **Cilësia e shërbimeve**

Kontributi i sektorit të shëndetësisë në përmirësimin e cilësisë ka vazhduar edhe në vitin 2017 me mbiqëqyrjen e gjendjes në teren, qasjen ndaj problematikave, temat e prezantuara në sesione, diskutimet dhe vendimet për planifikimin e ardhshëm. Këto aktivitete janë mbajtur nëpër lokacione të ndryshme, ku nënat dhe fëmijët janë udhëzuar dhe trajnuar rreth kujdesit shëndetësor të përgjithshëm dhe, në veçanti, rreth shëndetit dhe kujdesit të fëmijëve.

OJQ "Save the Children në bashkëpunim me Komunën e Klinës dhe në veçanti me QKMF-në kanë identifikuar tema dhe me kujdes të veçantë kanë punuar në përgatitjen dhe organizimin e aktiviteteve të shumta edukuese e informuese. Kujdes i veçantë i është kushtuar kujdesit të fëmijëve që



nga faza para lindjes dhe duke e përcjellur atë në etapat e rëndësishme të rritjes së tyre. Shquhen temat çfarë duhet të dijnë nënat para lindjes, të ushqyerit me qumësht të gjirit, kolla apo ftohjet te fëmijët, higjiena orale dhe vaksinimi. Sesionet janë mbajtur në dy lokacione: në shkollën fillore të fshatit Zajm dhe në Çerdhen "Xhevë LLadrovci" në Klinë me fëmijë deri në moshën 5 vjeçare, të shoqëruar me nënat e tyre. Pjesëmarrja ka qenë e kënaqshme dhe temat janë pëlqyer shumë. Duke u bazuar në pyetjet dhe bashkëpunimin gjatë sesioneve vërehet që temat kanë dhënë përgjigje, për të cilat ka pasur nevojë. Gatishmëri bashkëpunimi është treguar me secilën organizatë që ndihmon dhe kontribuon në realizimin e projekteve të dobishme për banorët e Klinës, ashtu siç është praktikuar bashkëpunimi me "Save the Children". Bashkëpunimi në mes të Save the Children dhe Komunës së Klinës, respektivisht QKMF "Nënë Tereza", ka rezultuar në një sukses dhe ka arritur qëllimin e vet që të jepen informata të duhura, të cilat do t'u ndihmojnë nënave që të kenë njohuritë e duhura rreth kujdesit për vetveten dhe për shëndetin e fëmijëve të tyre

### **Aktivitetet profesionale të ZHVP-së**

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional dhe nevoja e sigurimit të pikëve rilicencuese të personelit mjekësor, i bazuar në dispozitat e Nenit 75 të Ligjit për Shëndetësi nr.04/L-125, me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes së kualifikimeve të tyre profesionale, ka vazhduar përgjatë vitit 2017, me ç'rast janë krijuar mundësitë e aftësisimit të nevojshëm, përgatitjes së kuadrove me risitë dhe evoluimet e ndryshme në fushën e shëndetësisë dhe plotësimit të kriterëve për rilicencim. Rilencimi i mjekëve dhe infermierëve ka vazhduar me dy ligjërata profesionale në muaj për mjekë dhe infermierë.

Në kuadër të masave parandaluese për luftimin e etheve hemoragjike, të quajtura Krime Kongo, konkretisht, në Komunën e Klinës, si zonë mjaft e ekspozuar, Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale, pas takimeve paraprake, konsultave dhe koordinimit të plotë me institucionet përkatëse, ka organizuar ligjëratat profesionale në 24 shkolla të mesme të ulëta, të cilat janë mbajtur nga data 3– 18.03 2017, në mënyrë që të kontribuohet për vetëdijësimin e qytetarëve lidhur me pasojat dhe ndërmarrjen e masave preventive ndaj kësaj sëmundjeje.

### **Asgjësimi i mbetjeve të pajisjeve dhe produkteve mjekësore**

Meqë asgjësimi i mbetjeve dhe pajisjeve të veçanta mjekësore nuk është në domenin lokal të kompetencave tona, disa herë kemi bërë kërkesa me shkrim dhe kemi takuar ish-ministrin e MSH-së, së bashku me drejtoreshën e QKMF-së "Nënë Tereza", Dr.Drita Gjergji, lidhur me asgjësimin e mbetjeve të pajisjeve dhe produkteve mjekësore në QKMF, QMF DHE AMF, të mbledhura para vitit 2014 deri më sot, ne, prapëseprapë, nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Në informacionin e dërguar në MSH kemi bashkëngjitur regjistrin e pajisjeve dhe mbetjeve të produkteve medicinale, vendin e magazinimit, llojin e tyre, datën e skadimit, numrin e paketimit dhe sasinë. Meqë këto mbeturina zënë një hapësirë të konsiderueshme të objekteve shëndetësore dhe konsiderohen të rrezikshme, presim që në vitin 2018 të fillojnë procedurat konkrete për asgjësimin e tyre.

Në këtë kuadër Dr. Drita Gjergji ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me Spitalin Rajonal në Pejë për asgjësimin e tipeve të veçanta të mbetjeve medicinale në QKMF, QMF dhe AMF, por që nuk ka të bëjë me informacionin e lartcekur për asgjësimet e llojeve të tjera. Gjitashtu jemi pajisur me 15 kontejnerë të mbeturinave për QKMF, QMF dhe AMF dhe është nënshkruar kontratë me kompaninë e pastimit në përputhje me procedurat ligjore.

### **Përspektiva e së ardhmes dhe sfidat**

Një fokus të zgjeruar të zhvillimit strukturor të sistemit shëndetësor në Klinë paraqet Strategjia e Zhvillimit Komunal 2017-2021, që tejkalon kufijtë e mandateve politike (për të cilën gjatë vitit 2017 kemi dhënë kontributin tonë si sektor shëndetësor), duke pasur në vëmendje instrumente të caktuara për



projektet shëndetësore që do të realizohen. Në këtë strategji reflekton një qartësi dhe konkretësi e vizionit dhe zbatueshmërisë strategjike të avancimit të këtij sektori në të ardhmen. Vlen të përmendet projektimi dhe riorganizimi i Mjekësisë Familjare që parashihet në strategji, në ndarjet dhe nëndarjet strikte dhe praktike, duke marrë për bazë edhe evoluimet e reja, që do të fillojnë së aplikuari me Ligjin për sigurime shëndetësore dhe kategorizimin e vijës horizontale dhe vertikale të menaxhimit, që do të determinohet në të ardhmen

*Si sfida vijuese të çështjeve shëndetësore lokale mbetet edhe më tej realizimi i listës esenciale nga ana e MSH-së dhe sigurimi i fondeve për listën komerciale. Në hulumtim e sipër kemi hasur tendenca të shmangies për marrjen e shërbimeve nëpër ambulantat e mjekësisë familjare, ku një ndër shkaqet është edhe mungesa e kuadrove të përhershme, të vendosura në këto institucione shëndetësore – pra nevojitet planifikim i buxhetit shtesë për plotësimin me kaudro të ambulantave të mjekësisë familjare, në mënyrë që të zhvillohet në mënyrë të rregullt veprimtaria shëndetësore. Rreziqet e mëtejshme potenciale që kuptohen nga raportet dhe pasqyrat vjetore të menaxhimit të institucioneve shëndetësore primare vijnë nga dualizmat e insitucioneve publike dhe private shëndetësore.*



**KRYETARI:**

**Zenun Elezaj**